

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6114  
E martë, 15 shtator 2020  
çmimi 0.40 €

950 zyrtarë të  
lartë publikë do t'i  
nënshtrohen kontrollit  
të plotë të pasurisë | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAGMI MUSTAFA | FAQE 4-5



## PADITË E SERBISË NUK MUND TË MË ZMBRAP SIN NË BETEJËN PËR DREJTËSI

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa, nuk i frikësohet padisë së Gjykatës së Vranjës e cila e akuzon atë për ngritjen e flamurit kombëtar në seli të Këshillit Kombëtar. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai këtë padi e ka cilësuar politike. Mustafa ka thënë se paditë e institucioneve serbe nuk do të mund ta ndalin nga beteja për drejtësi. Sipas tij, shqiptarët e kanë të garantuar të

drejtën e përdorimit të simboleve kombëtare me Kushtetutën e Serbisë. Mustafa ka ftuar institucionet e Serbisë që ta ndryshojnë ligjin për përdorimin dhe shfaqjen publike të simboleve nacionale

## Nxënësit ia nisin mësimin me bartje të maskës

Pas pauzës prej gjashtë muajsh për shkak të pandemisë Covid-19, nxënësit të hënën janë kthyer në shkollë me maska në fytyrë dhe duke respektuar distancën fizike dhe përkujdesur për higjienën. Autoritetet shtetërore kanë njoftuar se kanë shpërndarë gjysmë milioni maska nëpër shkollat e Kosovës. Në bashkëbisedim me mësimdhënësit dhe me menaxhmentin e shkollave, ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka theksuar se



ministra që drejton, si dhe institucionet e tjera qendrore dhe lokale, do të jenë afër shkollave vazhdimisht, në mënyrë që procesi mësimor të menaxhohet sa më mirë | FAQE 2

## Pjetër Ndrecaj dënohet me 24 vjet burgim për vrasjen e bashkëshortes dhe të vajzës

| FAQE 7



### AKTUALE

**HOTI TË ENJTEN RAPORTON  
NË KUVEND PËR DIALOGUN  
KOSOVË - SERBI** F. 5

**BIE NUMRI I TË INFETUARVE  
ME COVID, PËR 24 ORË  
55 RASTE TË REJA** F. 3

**HOTI DHE HARADINAJ-STUBLLA  
I INFORMOJNË AMBASADORËT  
PËR MARRËVESHJEN NË  
UASHINGTON** F. 7



### EKONOMI

**QEVERIA MIRATON KORNIZËN  
AFATMESME TË SHPENZIMEVE  
TË RISHIKUARA PËR VITET  
2021-2023** F. 8

**QEVERIA NUK HEQ DORË NGA  
NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT  
'KOSOVA E RE'** F. 8



### SPORT

**BASKETBOLLISTËT:  
LIGA UNIKE, E MIRËSEARDHUR  
PËR TALENTËT** F. 16



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Nxënësit ia nisin mësimin me bartje të maskës

Pas pauzës prej gjashtë muajsh për shkak të pandemisë Covid-19, nxënësit të hënën janë kthyer në shkollë me maska në fytyrë dhe duke respektuar distancën fizike dhe përkujdesur për higjienën. Autoritetet shtetërore kanë njoftuar se kanë shpërndarë gjysmë milioni maska nëpër shkollat e Kosovës. Në bashkëbisedim me mësimdhënësit dhe me menaxhmentin e shkollave, ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka theksuar se ministria që drejton si dhe institucionet e tjera qendrore dhe lokale do të jenë afër shkollave vazhdimisht në mënyrë që procesi mësimor të menaxhohet sa më mirë



**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 14 SHTATOR** - Në Kosovë të hënën ka nisur viti i ri shkollor, teksa Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka njoftuar se janë bërë të gjitha përgatitjet që procesi mësimor të zhvillohet duke respektuar masat për mbrojtje nga sëmundja Covid-19. Nxënësit dhe mësimdhënësit duhet të mbajnë maska në ambientet shkollorë. Sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, shkollat duhet të sigurojnë që të respektohet distanca e caktuar e sigurisë të paktën 1.5 metra. Secilit nxënës si dhe personelit të shkollës duhet t'i bëhet matja e temperaturës përmes termometrit laserik çdo ditë. Autoritetet shtetërore të Kosovës kanë njoftuar se kanë shpërndarë gjysmë milioni

maska nëpër shkollat e Kosovës. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani dhe drejtoresha e DKA-së në Prishtinë, Shpresa Shala, kanë vizituar shkollën "Iliria" dhe Shkollën e Gjelbër në Prishtinë për ta parë nga afër fillimin e procesit të mësimin.

Ministri Likaj ka qëndruar në disa klasë, ku ka bashkëbiseduar me nxënësit të cilët janë shprehur të lumtur që janë kthyer përsëri në shkollë dhe janë takuar me shokët, shoqet dhe mësuesit. Po ashtu, ministri Likaj ka biseduar me nxënësit edhe për rëndësinë që ka respektimi i rregullave në oborrin e shkollës, në shkollë dhe në klasë, ndërsa iu ka uruar shëndet dhe suksese atyre dhe të gjithë nxënësve në

Republikën e Kosovës. Në bashkëbisedim me mësimdhënësit dhe me menaxhmentin e shkollave, ministri Likaj ka theksuar se Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe institucionet e tjera qendrore dhe lokale, do të jenë afër shkollave vazhdimisht, në mënyrë që procesi mësimor të menaxhohet sa më mirë.

Ministri i Arsimit ka thënë se është i kënaqur me përgatitjet që kanë bërë këto shkolla, duke i respektuar në tërësi udhëzuesit dhe protokollet për fillimin e mësimin në kushte pandemie.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se dita e parë e shkollës është moment që reflekton rolin madhor që ka edukimi në shoqëri, ndërsa ka theksuar se rikthimi në bankat shkollorë është i rëndësishëm dhe interes jetësor i të gjithëve. "Në

këto kushte pandemie, gjithnjë sipas udhëzimeve, janë bërë të gjitha përgatitjet, dezinfektimi i hapësirave shkollorë, shenjzimet paralajmëruese, në klasa është bërë reduktimi i numrit të nxënësve për ta ruajtur distancën fizike, nxënësit bartnin maska si dhe në hapësira të caktuara ishin vendosur dezinfektues", ka thënë ai, duke shtuar se Ministria e Shëndetësisë, bashkë edhe me të gjithë aktorët e tjerë, të rëndësishëm dhe të domosdoshëm në këtë

proces, janë maksimalisht të përkushtuar që ta menaxhojnë sa më mirë situatën. "Natyrshëm që ky vit shkollor është më i vështirë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia andaj edhe duhet që të gjithë të angazhohemi, secili në detyrat dhe përgjegjësit e veta, për respektimin e masave parandaluese të virusit. Urime për të gjithë nxënësit! Paçin një fillim të mbarë, shëndet, suksese, më shumë dije dhe rezultate pozitive!", ka thënë Zemaj.

## SBASHK-u uron nxënësit dhe punëtorët e arsimit

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka uruar nxënësit dhe mësimdhënësit për fillimin e vitit të ri shkollor. "Nxënës dhe ju kolegë të nderuar kudo jeni, urime fillimi i vitit të ri shkollor. Informatat që kemi marrë nga kryetarët e shoqatave sindikale përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal tregojnë se në të gjitha komunat e Kosovës 14 shtatori shënoi fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor. Duke vazhduar angazhimet në të njëjtin front, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, SBASHK-u dhe prindërit do t'i tejkalojmë vështirësitë. Ju kolegë të nderuar do ta zhvillojmë betejën për rrugëtimin drejt njohurive të reja për nxënësit e Kosovës,

por edhe betejën për ta ruajtur shëndetin personal, shëndetin e kolegëve dhe të fëmijëve, që janë stolia më e bukur e atdheut tonë", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

Kjo syndikatë ka theksuar se edhe në të kaluarën i kanë mposhtur vështirësitë dhe kanë ngadhënjyer duke e ruajtur arsimin. "Bashkë do të angazhohemi edhe tani dhe do t'i tejkalojmë vështirësitë në shërbim të edukimit dhe arsimimit të brezave. Kolegë të nderuar, punëtorë të arsimit, na qoftë i mbarë ky vit i ri shkollor. Ju premtojmë se SBASHK-u në bashkëpunim me MASH-in do të angazhohen edhe për realizimin e kërkesave të drejta e legjitime të punëtorëve të arsimit", është theksuar në komunikatën e SBASHK-ut.



# Bie numri i të infektuarve me Covid, për 24 orë 55 raste të reja

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë katër persona nga Covid-19, janë shënuar 55 raste të reja dhe janë shëruar 150 pacientë. Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se qytetarët dhe institucionet nuk duhet ta ulin për asnjë çast vëmendjen ndaj Covid-19


**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka treguar se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë katër persona nga Covid-19 në Kosovë.

IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shënuar edhe 55 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 574 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 55 raste pozitive.

Brenda 24 orëve janë raportuar 4 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 14 692 raste nga 58 425 persona të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe 600 raste të vdekjes", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Sipas njoftimit, janë shëruar edhe 150 pacientë nga Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 150 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 11 585 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 507. Rastet pozitive janë nga: komuna Gjakovë 9 raste, komuna Prishtinë 8 raste, komuna Gjilan 6 raste, komuna Ferizaj 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Pejë 3 raste,



komuna Viti 3 raste, komuna Fushë Kosovë 2 raste, komuna Hani i Elezit 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Lipjan 2 raste, komuna Mitrovicë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Podujevë 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Junik, Kamenicë dhe Skenderaj", është thënë në njoftim.

## Zemaj: Për asnjë çast të mos ulet vëmendja ndaj Covidit

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë thirrje sërish që të vazhdohet respektimi i masave anti Covid. Në një konferencë për media mbajtur të hënën, ai ka deklaruar se ka rënie graduale të rasteve të reja të infektimit me Covid. Megjithatë, Zemaj ka theksuar se kjo nuk duhet t'i bëjë institucionet të ndihen më pak përgjegjëse se deri më tani. "Siç keni vërejtur në ditët dhe javët e fundit, Kosova këto ditë po regjistron numër më të vogël të rasteve pozitive Covid-19. Edhe sot kjo rënie graduale

po stabilizohet, por nuk duhet të na bëjë të ndihemi më pak përgjegjës se deri më tani, prandaj kërkojmë që të vazhdohet disiplina për zbatimin e masave, për bartje të maskës mbrojtëse, për ruajtje të distancës dhe përkujdesje për higjienën", ka thënë Zemaj.

Ai ka deklaruar se Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë t'i mbështesë profesionistët shëndetësorë në punën e tyre si dhe organet e rendit që të zbatohen me përpikëri masat e ndërmarra në fuqi. "Këtyre ditëve jemi në kontakte edhe me vendet e rajonit për ta parë mundësinë e lehtësimit të qarkullimit pa iu nënshtruar testeve që kërkohen në vendet fqinjë për shtetasit e Kosovës dhe anasjelltas, por e tëra kjo varet nga situata epidemiologjike në ato vende dhe te ne. Fatmirësisht, situata më e qetë në Kosovë na jep shpresë se do të pranohen kërkesat tona", është shprehur ai, duke shtuar se në ndërkohë do të përgatiten intensivisht si në riorganizimin e kapaciteteve spitalore, me qëllim që sezoni i

vjeshtës dhe dimrit t'i gjejë institucionet të gatshme për t'u ballafaquar me secilin skenar të mundshëm. "Në këtë aspekt, MSH ka kontraktuar përmes UNICEF-it 165 mijë vaksina kundër gripit sezonal, kontingjentet e para të cilave presim të arrijnë dhe të shpërndahen në tetor, kurse tenderi për pjesën tjetër të vaksinave është anuluar nga Ministria e Shëndetësisë, e cila nuk do të pranojë që kompanitë farmaceutike, duke shfrytëzuar situatën me Covid-19, të abuzojnë me ngritje të çmimeve të ofertave siç kanë bërë. Ne do ta sigurojmë edhe pjesën tjetër të vaksinave (rreth 300 000), por jo me çmime abuzive, por me çmime tregu", ka deklaruar ai. Zemaj ka vlerësuar se qytetarët nuk duhet ta ulin për asnjë çast vëmendjen ndaj Covid-19 dhe duhet t'i zbatojnë të gjitha masat në fuqi. "Deri në zhvillimin, aprovimin dhe përdorimin e vaksinës anti Covid-19 nuk kemi rrugë tjetër më të lehtë dhe më të lirë se bartja e maskës, ruajtja e distancës dhe mbajtja e higjienës", ka thënë Zemaj.



# Szunnyog: BE-ja e përkushtuar ta ndihmojë Kosovën në rrugën evropiane

PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në takim të parë njoftues shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunnyog, me të cilin ka diskutuar për bashkëpunimin e Qeverisë me Zyrën e Bashkimit Evropian në Prishtinë.

Kryeministri Hoti ka shprehur gatishmërinë e kabinetit qeveritar që ky bashkëpunim të thellohet dhe të zhvillohet në frymën e respektit dhe komunikimit të drejtpërdrejtë për të gjitha çështjet. "Integrimi në Bashkimin Evropian është synimi ynë strategjik. Andaj, do të jemi të hapur dhe bashkëpunues në

vazhdimësi për ta implementuar agjendën tonë të integritimit", ka theksuar Hoti.

Sipas njoftimit të qeverisë, kryeministri në këtë takim ka shtruar çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, duke theksuar se institucionet e Republikës së Kosovës i kanë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga BE-ja për këtë çështje. "Ne vërtet jemi të interesuar që liberalizimi i vizave të ndodhë sa më shpejt dhe jemi të përkushtuar të punojmë ngushtë me të gjitha vendet e BE-së, sidomos me ato që kanë hezitime, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të lëvizin



lirshëm si të gjithë qytetarët e tjerë të Evropës", ka deklaruar Hoti.

Ndërsa përfaqësuesi i posaçëm i BE-së, Tomas

Szunnyog, ka pohuar angazhimin e tij për t'i vazhduar marrëdhëniet e mira dhe funksionale me institucionet e Republikës së

Kosovës. "Bashkimi Evropian është i përkushtuar për ta ndihmuar Kosovën në proceset e zhvillimit të përgjithshëm si dhe bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian", ka theksuar Szunnyog, duke shtuar se BE-ja do ta vazhdojë angazhimin për mbështetjen e agjendës evropiane të Kosovës dhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Në këtë takim është diskutuar edhe për vazhdimin e punës së përbashkët në të gjitha fushat e bashkëpunimit që janë identifikuar deri tash, si dhe është konfirmuar gatishmëria e të dyja palëve për t'i çuar përpara proceset e bashkëpunimit.



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAGMI MUSTAFA

# PADITË E SERBISË NUK MUND TË MË ZMBRAPSIN NË BETEJËN PËR DREJTËSI

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa, nuk i frikësohet padisë së Gjykatës së Vranjës e cila e akuzon atë për ngritjen e flamurit kombëtar në seli të Këshillit Kombëtar. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai këtë padi e ka cilësuar politike. Mustafa ka thënë se paditë e institucioneve serbe nuk do të mund ta ndalin nga beteja e tij për drejtësi. Sipas tij, shqiptarët e kanë të garantuar të drejtën e përdorimit të simboleve kombëtare me Kushtetutën e Serbisë. Mustafa ka ftuar institucionet e Serbisë që ta ndryshojnë ligjin për përdorimin dhe shfaqjen publike të simboleve nacionale

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa, e ka quajtur politike padinë e ngritur ndaj tij nga Gjykata e Vranjës për ngritjen e flamurit kombëtar shqiptar më 28 nëntor të vitit të kaluar. Ai ka

deklaruar se paditë e tilla nuk do ta zbrapsin në betejën për drejtësi. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka treguar arsyet pse i është ngritur kjo padi. "Padia e ngritur nga Gjykata e Vranjës është e motivuar politikisht. Ajo bazohet nën pretendimin e shkeljes së nenit 41 të Ligjit për shfaqjen dhe përdorimin e

stemës, flamurit dhe himnit të Republikës së Serbisë, që parasheh dënim nga 50 000 deri në 500 000 dinarë. Kot e kanë. Edhe mund të më dënojnë, por nuk mund të më zbrapsin nga beteja për drejtësi", ka deklaruar Mustafa.

Ai ka bërë me dije se shqiptarët e kanë të garantuar të drejtën e përdorimit të simboleve

kombëtare me Kushtetutën e Serbisë. "Rikujto se Kushtetuta e Republikës së Serbisë, kapitulli 'E drejta për t'i ruajtur tiparet e veçanta', përkatësisht Neni 79, thekson se 'Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të: shprehin, ruajnë, kultivojnë, zhvillojnë dhe shprehin publikisht veçoritë kombëtare, etnike, kulturore dhe fetare; për përdorimin e simboleve të tyre në vendet publike; ta përdorin gjuhën dhe shkrimin e tyre...'. Pra, e drejta e përdorimit të simboleve kombëtare për minoritetet jo vetëm se është e drejtë e garantuar me të gjitha konventat ndërkombëtare, por edhe me frymën dhe gërmat e Kushtetutës së Serbisë", ka deklaruar ai.

Mustafa i ka ftuar institucionet e Serbisë që të çlirohen nga

politikën shtypëse duke e ndryshuar ligjin për përdorimin dhe shfaqjen publike të simboleve nacionale. "Në vend se t'i shtypë shqiptarët në emër të shtetit ligjor, Serbia ta respektojë Kushtetutën dhe ta fillojë demokratizimin e saj duke u shkëputur nga politikën diskriminuese ndaj minoriteteve. Të çlirohet nga politikën shtypëse duke e ndryshuar ligjin për përdorimin dhe shfaqjen publike të simboleve nacionale, për ta përputhur me Kushtetutën e vet dhe standardet demokratike", ka thënë ai.

Mustafa ka përshëndetur marrëveshjen e Uashingtonit e cila është arritur më 4 shtator në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ne e mirëpresim posaçërisht pikën e 6 të kësaj



beteja për drejtësi. Rikujtoj se Kushtetuta e Republikës së Serbisë, kapitulli 'E drejta për të ruajtur tiparet e veçanta', përkrahësit Neni 79, thekson se 'Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë ta: shprehin, ruajnë, kultivojnë, zhvillojnë dhe shprehin publikisht veçoritë kombëtare, etnike, kulturore dhe fetare; për përdorimin e simboleve të tyre në vendet publike; ta përdorin gjuhën dhe shkrimin e tyre...' Pra, e drejta e përdorimit të simboleve kombëtare për minoritetet jo vetëm se është e drejtë e garantuar me të gjitha konventat ndërkombëtare, por edhe me frymën dhe gërmat e Kushtetutës së Serbisë. Në vend se t'i shtypë shqiptarët në emër të shtetit ligjor, Serbia ta respektojë Kushtetutën e vet dhe ta fillojë demokratizimin e saj duke u shkëputur nga politikat diskriminuese ndaj minoriteteve. Të çlirohet nga politikat shtypëse duke e ndryshuar ligjin për përdorimin dhe shfaqjen publike të simboleve nacionale, për ta përputhur me Kushtetutën e vet dhe standardet demokratike.

**"Epoka e re": Çfarë do të thotë për shqiptarët e kësaj ane një padi e tillë? Paraqet mesazh frikësues?**

**Mustafa:** Përdorimi i simboleve kombëtare nga shqiptarët në Serbi është e drejtë e tyre njerëzore, kombëtare dhe ekzistenciale. Siç i përdorin ligjshëm simbolet e tyre kombëtare minoritetet e tjera në rajon, edhe shqiptarët në Serbi do t'i përdorin simbolet e tyre kombëtare. Nga kjo e drejtë nuk do të mund të na privojë asnjë regjim. Nuk ka mundur as regjimi i Millosheviqit, nuk do të mundet as ky. Serbia nuk mund ta për zgjedhë flamurin e shtetasve të vet shqiptarë. Atë e për zgjedhin vetë shqiptarët! Ky ligj është flamur i shtypjes. Ky flamur është ligj i barazisë. Prandaj ligji do të ndryshojë, jo flamuri.

**"Epoka e re": Ka pasur edhe raste të tjera ku qytetarët shqiptarë janë akuzuar për flamurin kombëtar. A kanë të drejtë shqiptarët ta përdorin flamurin e tyre në Serbi?**

**Mustafa:** Intervenimet nga autoritetet policore në shtëpi private për ta ndaluar flamurin kombëtar shqiptar kanë qenë të shumta. Jo pak shqiptarë të Luginës nuk mund të jetojnë në vendlindje për shkak të ngritjes së flamurit kombëtar shqiptar. Shumë të tjerë janë përballur me procese gjyqësore si sot unë e që dëshmon diskriminimin dhe shtypjen e shtetit ndaj diversitetit, të ndryshmes, asaj që nuk është serbe. Ky rast dhe raste të tjera të regjistruara të abuzimit me përdorimin e autoritetit gjyqësor/policore, flasin për karakterin demokratik të vet shtetit, një shteti ku nuk ka të drejta të barabarta për të

gjithë qytetarët, në shpërputhje edhe me konventat për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, të nënshkuara nga vetë ai.

**"Epoka e re": Kosova dhe Serbia po vazhdojnë dialogun për normalizim të marrëdhënieve, ndërkohë nuk dihet nëse do të diskutohet për çështjen e shqiptarëve të Luginës. A do të duhej që pjesë e këtij procesi të bëhen të drejtat e shqiptarëve të Luginës?**

**Mustafa:** Janë shtuar zërat se në dialogun Kosovë - Serbi nuk duhet biseduar për çështjet përtej kufijve të tanishëm të Republikës së Kosovës. Kjo qasje që ka për synim të "ndërhyhet" vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me Kosovën, përjashton mundësinë të "ndërhyhet" në çështjet që kanë të bëjnë me Serbinë, pra edhe me Luginën e Preshevës. Sigurisht se janë palët e përfshira në dialog që i

përcaktojnë përkufizimet, kornizën, parimet dhe kriteret e dialogut. Por, nëse duam dialog midis të barabartëve dhe paqe të qëndrueshme, atëherë kjo nënkupton se çfarëdo teme eventuale që mund të jetë subjekt negociatash (kufijtë e jashtëm, rendi kushtetues, rregullimi i brendshëm administrativo-territorial, burimet natyrore dhe asetet ekonomike, të drejtat e minoriteteve, krimet e luftës dhe zbardhja e fatit të të pagjeturve etj.) duhet të trajtohet për të dy vendet të cilat janë palë në dialog.

**"Epoka e re": Cili është qëndrimi juaj për marrëveshjen e Uashingtonit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?**

**Mustafa:** Inkurajuese dhe e mirëseardhur marrëveshja e arritur në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë në Shtëpinë e Bardhë në

Uashington. Ne e mirëpresim posaçërisht pikën 6 të kësaj marrëveshje, ku nënvizohet: "Të dyja palët do t'i njohin diplomat dhe certifikatat profesionale të njëra-tjetrës", si dhe pikën tjetër ku flitet për refugjatët dhe të zhvendosurit. E para nënkupton njohjen e diplomave të Kosovës në Serbi, një problem jetik për shumë shqiptarë të Luginës së Preshevës të cilët kanë diplomuar në Kosovë. E dyta ka të bëjë me rregullimin e statusit juridik meqë shqiptarët e Karadakut të Preshevës, Malësisë së Bujanocit dhe të Medvegjës janë dëbuar e tashmë janë duke u përballur me pasivizimin e vendbanimeve që nënkupton 'spastrimin e heshtur etnik'. Shpreh gatishmërinë për të kontribuar në implementimin e këtyre çështjeve, tashmë të pajtuar midis palëve nën garancitë e presidentit të ShBA-së, Donald Trump.

## Hoti të enjten raporton në Kuvend për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka treguar se kryeministri Avdullah Hoti të enjten do të raportojë në Kuvend për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ajo ka deklaruar se pas raportimit të kryeministrit, në këtë seancë do të mbahen edhe dy interpelanca parlamentare. Në konferencën për media, Osmani ka thënë se dështimi për miratimin e disa projektligjeve në sesionin e kaluar është për fajin e koalicionit qeverisës. "Mbi 120 ligje qeveria nuk i pat proceduar

në Kuvend në sesionin e mëparshëm. Pa i proceduar Qeveria ka qenë e pamundur që Kuvendi t'i procedojë. Kuvendi ka dëshmuar se të gjitha çështjet që i kanë kryer procedurat e brendshme janë sjellë në seancë", ka deklaruar Osmani. Kryeministri Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kanë nënshkruar më 4 shtator, në Shtëpinë e Bardhë, një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja është nënshkruar në praninë e presidentit amerikan

Donald Trump.

Dy palët, megjithatë, nuk i kanë hedhur nënshkrimet në dokumentin e njëjtë, por secila veç e veç i ka nënshkruar zotimet e saj. Trumpi, në anën tjetër, ka nënshkruar një letër, përmes së cilës i ka përgëzuar palët për guximin drejt përparimit të normalizimit të marrëdhënieve. Hoti dhe Vuçiqi janë takuar edhe më 7 shtator në Bruksel, ku kanë thënë se kanë hapur temat e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, si dhe ato të çështjeve financiare dhe pronësore.



## 950 zyrtarë të lartë publikë do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë

PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, Agjencia Kundër Korrupsionit do ta bëjë kontrollin e plotë të pasurisë të 20 për qind të

zyrtarëve që janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre.

Nga gjithsej 4 751 subjekte deklaruuese, formularët e 950 zyrtarëve do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë nga Agjencia. Përveç kësaj liste të dalë nga shorti publik, Agjencia Kundër Korrupsionit ka mandat

ligjor që ta bëjë kontrollin e plotë të pasurisë edhe të zyrtarëve të tjerë që nuk janë përzgjedhur nga shorti, sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të publikut apo personave të tjerë të interesuar, në rastet kur ekzistojnë dyshime të bazuara në saktësinë dhe korrektësinë e deklarimeve.



## Kurti me përfaqësuesin special të Norvegjisë për Ballkan diskuton për zhvillimet në Kosovë

PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ish-ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, kanë pritur të hënën në takim përfaqësuesin special të Norvegjisë për Ballkan, Arne Sannes Bjornstad, dhe ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl. Sipas njoftimit të LV-së, gjatë këtij takimi janë përfshirë shumë tema. "U diskutua mbi situatën tejet të rënduar me Covid-19 nga qershori e këndej dhe për rrezikun e përkeqësimit me



ardhjen e stinës së vjeshtës dhe dimrit. Bashkëpunimi ndërmjet

dy vendeve është shprehur edhe në ndihmat e fundit me 20

respiratorë nga Norvegjia. Ndër çështjet e trajtuara ishte edhe

situata gjeopolitike në Ballkan e më gjerë, dialogu me Serbinë dhe katër lëndët e adresuara nga Vetëvendosje në Gjykatën Kushtetuese për të cilat po priten vendimet si dhe përgatitjet që po bën Lëvizja për zgjedhjet e reja", është theksuar në njoftimin e LV-së.

Kurti ka falënderuar përfaqësuesin special të Norvegjisë për Ballkan, Bjornstad, dhe ambasadorin Grondahl për përkrahjen e vazhdueshme të Norvegjisë ndaj Kosovës dhe u zotua për fuqizimin e bashkëpunimit mes dy vendeve.

## Covid-19, UNICEF-i ka nisur fushatën 'S'ka ma lehtë'

PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Përderisa pandemia Covid-19 po vazhdon, zyra e UNICEF-it në Kosovë së bashku me partnerët po bëjnë të gjitha përpjekjet për mbështetjen e institucioneve të Kosovës për vetëdijesimin e popullatës si dhe për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Në kuadër të bashkëpunimit me ambasadorin e Japonisë në Kosovë dhe iniciativës për fuqizimin dhe përfshirjen e të rinjve në zgjedhjet për komunitetin, të hënën është lansuar fushata "S'ka ma lehtë", fushatë kjo e dizajnuar nga të rinjtë për vetëdijesimin e popullatës mbi rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse nga Covid-19. Fushata vetëdijësuese do të implementohet në 15 komuna të Kosovës: Prishtinë, Obiliq, Podujevë, Drenas, Vushtrri, Mitrovicë, Graçanicë, Prizren,

Dragash, Lipjan, Gjiçan, Gjakovë, Zubin Potok, Shtime dhe Kaçanik, kurse do të realizohet nga vullnetarët e rinj të këtyre komunave.

Të gjitha aktivitetet do të realizohen duke respektuar në tërësi masat mbrojtëse të parapara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si dhe Instituti i Shëndetit Publik në Kosovë. Ndërsa në fokus do të jenë aktivitetet për mbarëvajtjen e rendit dhe masave mbrojtëse në shkollat publike në komunat ku do të implementohet fushata dhe në sheshet kryesore, si dhe shpërndarja e sa më shumë mesazheve vetëdijësuese për mbrojtjen nga Covid-19.

Kjo fushatë udhëhiqet nga UNICEF Innovations Lab Kosova dhe realizohet në bashkëpunim me organizatën partnere PEN.



## Ministri Krasniqi informohet me sfidat që po përballen prodhuesit



PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Përfaqësuesit e Klubit të Prodhuesve të Kosovës kanë zhvilluar një takim pune me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, të cilën e kanë falënderuar dhe përkrahur për ftesën publike drejtuar institucioneve publike dhe shtetërore të vendit që t'i mbështesin prodhimet vendore. "Ftesë

kjo e cila kërkon që në procedurat e tenderimit këto institucione ta fusin si kriter edhe prodhimin vendor. Klubi i Prodhuesve e falënderoi ministrin Krasniqi dhe deklaroi që një ftesë e tillë tregon edhe një herë përkushtimin e kësaj ministrie për fuqizimin dhe zhvillimin e produkteve vendore, por edhe seriozitetin e ministrit në marrjen për

bazë të kërkesave të cilat janë shqyrtuar në takime të shumta me vetë prodhuesit", është thënë në njoftimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

Po gjatë takimit u diskutua edhe për sfidat me të cilat po përballen prodhuesit gjatë kohës së pandemisë, por edhe për kërkesat e menjëhershme të tyre për rimëkëmbje nga kjo gjendje.

# Pjetër Ndrecaj dënohet me 24 vjet burgim për vrasjen e bashkëshortes dhe të vajzës



Gjykata në Gjakovë e ka dënuar Pjetër Ndrecajn me 24 vjet e gjysmë burgim. Ndrecaj u soll i prangosur dhe me maskë mbrojtëse në seancën ku u shpall fajtor për vrasjen e gruas dhe të vajzës në fshatin Brekoc të Gjakovës në gusht të vitit 2018

vërtetuar faktike i akuzuari më 7 gusht 2018, në Gjakovë, në shtëpinë e vëllezërve të familjes së viktimës, ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij V. N. dhe

vajzën e tij K. N. Të akuzuarit i vazhdohet masa e paraburgimi deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit. Pala ka të drejtë ankese kundër këtij aktgjykimi

në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Ky rast ka qenë i kthyer në rigjykim, është thënë në njoftimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

## RrGK-ja dënon uljen e dënimit për Pjetër Ndrecajn

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) me shqetësim të thellë ka pranuar vendimin e Gjykatës Themelore të Gjakovës për uljen e dënimit për Pjetër Ndrecajn për vrasjen brutale të bashkëshortes dhe vajzës së tij në gusht të vitit 2018. "Dënimi prej 24 vjet e gjysmë burg, i shqiptuar pas rigjykimit ndaj Ndrecajt, është në kundërshtim të plotë, përveç me rrethanat e kryerjes së veprës, po ashtu edhe me rregullat e përgjithshme me të cilat parashihet zbutja apo ashpërsimi i dënimit. Vepra penale 'Vrasje e rëndë' në rastin Ndrecaj bart në vete dy kualifikime ligjore; vrasjen e bashkëshortes së tij, Valbona Ndrecaj si dhe vrasjen e fëmijës (vajzës 9-vjeçare). Për këtë veprë penale parashihet dënim me burgim të përjetshëm, në rastin konkret rrethanat e kryerjes së kësaj veprë, siç janë: mënyra e kryerjes së vrasjeve

dhe fakti që viktimat kanë qenë të pambrojtura është dashur të ndikojnë në ashpërsimin e dënimit duke iu shqiptuar dënim me burg të përjetshëm të pandehurit Ndrecaj", thuhet në reagimin e RrGK-së. Në këtë reagim theksohet se qëllimi i sanksionit është rehabilitimi i kryerësit të veprës si dhe krijimi i vetëdijes publike që personat që kryejnë vepra të tilla ndëshkohen. "Ulja e dënimit ndaj Ndrecajt jo vetëm se nuk do ta rehabilitojë atë, por do të shërbejë si motiv për të tjerët që të kryejnë vepra të ngjashme. Besojmë fuqishëm që Prokuroria do të ushtrojë ankesë dhe se Gjykata e Apelit do ta ndryshojë këtë aktgjykim për t'i shqiptuar dënim maksimal të pandehurit", është theksuar në reagimin e RrGK-së.

### **EPOKA ERE** Qendresa RAMA

**GJAKOVË, 14 SHTATOR** - Gjykata Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka shpallur aktgjykim dënues kundër të akuzuarit Pjetër Ndrecaj për dy vepra penale, "Vrasje e rëndë" dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", vepra të sanksionuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Pjetër Ndrecaj është dënuar me njëzet e katër (24) vjet burgim për vrasjen e gruas dhe vajzës së tij dhe me një (1) vit burgim për armëmbajtje pa leje. "I akuzuari P. N. është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim unik me

burg për dy veprat penale në kohëzgjatje prej njëzet e katër (24) vjet e gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 7 gusht 2018. I akuzuari është obliguar që të paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej dyqind (200) euro, shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej dyqind (200) euro si dhe shumën prej pesëdhjetë (50) euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar kundër të akuzuarit P. N., gjykata ka ardhur në përfundim se në bazë të gjendjes së

# Hoti dhe Haradinaj-Stublla informojnë ambasadorët për marrëveshjen e Uashingtonit

**PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER)** - Kryeministri Avdullah Hoti, ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, kanë mbajtur të hënën një videokonferencë me ambasadorët e Republikës së Kosovës që janë në mision diplomatike nëpër botë. Kryeministri Avdullah Hoti ka vlerësuar shumë rolin e ambasadorëve në forcimin e lidhjeve me vendet mike në të gjitha aspektet, e sidomos në orientimin euroatlantik të shtetit të Kosovës. "Nga ambasadorët kam kërkuar që me punën e tyre të jenë zë i fuqishëm i Kosovës në botë, pasi që Republika e Kosovës është në një fazë shumë të rëndësishme të shtetndërtimit dhe konsolidimit të përgjithshëm", ka shkruar Hoti në llogarinë e



vet në "Facebook". Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës është duke punuar ngushtë me partnerët dhe miqtë ndërkombëtarë për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, në procesin e

rimëkëmbjes ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19, si dhe në shumë procese nëpër të cilat është duke kaluar Kosova. Ministrja Haradinaj-Stublla ka bërë me dije se i kanë informuar ambasadorët

rreth marrëveshjes së arritur në Uashington për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike me Serbinë nën garancinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si hap i madh pararendës drejt marrëveshjes

finale për njohje reciproke. "Diskutoam pikat e marrëveshjes së Uashingtonit që ndërlihen me fushëveprimin e MPJD-së, në veçanti njohjen historike nga Izraeli dhe implementimin i kësaj marrëveshjeje ditëve në vijim", ka bërë me dije Haradinaj-Stublla. Ajo i ka falënderuar ambasadorët për punën e tyre të mirë përkundër gjendjes pandemike dhe masave të kufizimit. "U kërkova atyre dinamikë të shtuar të veprimit diplomatik për proklamimin e të vërtetës së Kosovës dhe proaktivitet në vendet pritëse që ta shfrytëzojnë momentumin e krijuar për të krijuar ura të reja miqësie me synimin e shtimit të njohjeve për Kosovën", është shprehur ministrja Haradinaj-Stublla.

# Qeveria miraton kornizën afatmesme të shpenzimeve të rishikuara për vitet 2021-2023

Rishikimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve është bërë me qëllim të reflektimit nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19 dhe ndikimeve që kjo situatë ka pasur në treguesit kryesorë të aktiviteteve ekonomike në vend. Kabinetit qeveritar, me propozimin e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka miratuar edhe koncept-dokumentin për skemat e ndihmës sociale



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 14 SHTATOR** - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka zhvilluar mbledhjen e rregull, të 30-n me radhë, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar pesë projektligje, gjashtë vendime, një koncept-dokument si dhe Rishikimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023.

Pesë projektligjet që kanë marrë miratimin e kabinetit qeveritar janë: 1. Projektligji për të drejtën ndërkombëtare private, i cili krijon rregullat për përcaktimin e të drejtës ndërkombëtare private. Projektligji përcakton edhe kompetencën e gjykatave dhe autoriteteve të tjera të Republikës së Kosovës sa i përket të drejtës ndërkombëtare private; 2. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, i cili forcon edhe më tej bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe eviton mangësitë e hasura në praktikën e zbatimit të ligjit në fjalë; 3. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për transferimin e personave të dënuar, i cili ratifikon marrëveshjen e cila do t'i përmirësojë të gjitha mangësitë, zbrazëtirat e evidentuara në fushën e transferimit të personave të dënuar nga të dyja vendet; 4. Projektligji për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Realizimin e projektit për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza në Gjilan. Projektligji ratifikon kontratën financiare ndërmjet republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për këtë projekt në

Komunën e Gjilanit; dhe 5. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për likuiditet të urgjencës së infrastrukturës vitale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, i cili do të ratifikojë dhe do ta bëjë të zbatueshme këtë marrëveshje. Dy vendime të Qeverisë për ndarje të mjeteve financiare për të siguruar realizimin e projekteve të rëndësishme të funksionimit institucional në Republikën e Kosovës janë miratuar në mbledhjen e sotme. 111,801.00 euro janë ndarë për realizimin projektit "Softueri për menaxhimin e proceseve të auditimit në Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe 230 mijë euro janë ndarë për sigurimin e procesit të deratizimit, dezinfektimit dhe dezinfektimit të ndërtesave qeveritare që menaxhohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë miratuar dy vendime. Vendimi i parë ka të bëjë me krijimin e grupit punues ndërinstitucional për avancimin e proceseve integruese euroatlantike të Republikës së Kosovës në Organizatën e Traktatit të

Atlantikut Verior - NATO. Vendimi tjetër i propozuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ka marrë miratimin e kabinetit qeveritar është vendimi për afirmimin e angazhimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për promovimin dhe forcimin e kujtesës ndaj Holokaustit dhe luftës kundër antisemitizmit në të gjitha format e tij. Në këtë funksion, Qeveria e Republikës së Kosovës kërkon nga autoritetet përgjegjëse që t'i ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë dhe ligjorë për njohjen e shprehjeve dhe të sjelljeve antisemitike. Qeveria ka miratuar edhe vendimin përfundimtar për shpronësimin e pronave të paluajtshme për interes publik, të cilat preken nga realizimi i projektit "Themelimi i qendrës përkujtimore për gjenocidin

mbi shqiptarët 'Bllaca 1999' në Hanin e Elezit.

Edhe vendimi për kriteret e financimit të projekteve të komunave të Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 është miratuar nga kabineti qeveritar në mbledhjen e sotme.

Qeveria ka diskutuar dhe në fund ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Rishikuara për vitet 2021-2023. Rishikimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve është bërë me qëllim të reflektimit nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19 dhe ndikimeve që kjo situatë ka pasur në treguesit kryesorë të aktiviteteve ekonomike në vend.

Në dokumentin e rishikuar thuhet se treguesit kryesorë ekonomikë gjatë muajve të

fundit të vitit 2020 ndryshojnë dukshëm në krahasim me periudhën gjatë përgatitjes së kornizës aktuale të shpenzimeve afatmesme.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, gjatë prezantimit para kabinetit qeveritar, ka theksuar se dokumenti i KASH-it ishte hartuar në muajin prill të 2020-s duke u bazuar në situatën socio-ekonomike të vështirësuar nga pandemia. Ajo shtoi se treguesit kryesorë ekonomikë përgjatë muajve të fundit evidentojnë se pritet për fundin e vitit 2020 ndryshojnë dukshëm në krahasim me periudhën gjatë së cilës u përgatit KASH-i fillestar prandaj, potencoi ajo, duke marrë parasysh rëndësinë e KASH-it në orientimin e përgatitjes së buxhetit për vitin 2021, MF-ja ka vendosur që për herë të parë ta rishikojë KASH-in. Bajrami nënvizoi se KASH 2021-2023 është i strukturuar në katër pjesë kryesore, ku përfshihen: Deklarata Afatmesme e Prioriteteve (e cila përmban prioritetet dhe dokumentet strategjike të qeverisë sikurse Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma në Ekonomi); korniza makro-fiskale e cila përmban parametrat e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit tonë; dhe në pjesën e tretë dhe të katërt janë paraqitur parashikimet fiskale të cilat përcaktojnë kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve mbi bazën e të cilëve përgatitet më vonë buxheti qendror dhe ai komunal.

## Miratohet koncept-dokumentin për skemat e ndihmës sociale

Në mbledhjen e së hënës të kabinetit qeveritar, me propozimin e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, është miratuar koncept-dokumentin për skemat e ndihmës sociale. Ministri Reçica ka thënë se "i kemi hapur rrugë hartimit të

një ligji të ri të skemës së ndihmës sociale, që do t'i eliminonte të gjitha diskriminimet e ligjit aktual". "Me fillimin e zbatimit të kësaj reforme do të kemi rritje të numrit të përfituesve të kësaj skeme të ndihmës sociale por, njëkohësisht, do të kemi

zvogëlim të varfërisë dhe, mbi të gjitha, rënie të pakënaqësive sociale. Si ministër i MPMS jam tejet i përkushtuar dhe në asnjë moment nuk do të ndalemi që reformat e mira që kemi ndërmarrë t'i jetësojmë sa më parë", ka deklaruar Reçica.

# Qeveria nuk heq dorë nga ndërtimi i termocentralit 'Kosova e re'



Qeveria e Kosovës thotë se, pavarësisht prej tërheqjes së kompanisë amerikane Contour Global nga ndërtimi i termocentralit 'Kosova e re', nuk kanë hequr dorë nga realizmi i këtij projekti, i cili synon ta shkarkojë Kosovën nga problemet që ka me furnizim stabil me energji elektrike

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Në mars të këtij viti kompania amerikane Contour Global, e cila ishte përzgjedhur nga qeveria për ndërtimin e këtij termocentrali me kapacitet 500 megavatë, pati njoftuar se do të tërhiqet nga plani për ndërtimin e termocentralit për arsye se kompania nuk e ka ndërmend të ndërtojë projekte me thëngjill në të ardhmen. Megjithatë, Uran Haxha, zëdhënës në Ministrinë e Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, tha për "Radion Evropa e Lirë" se janë duke shikuar modalitetet rreth projektit të termocentralit 'Kosova e re'. "Qeveria e Kosovës nuk ka marrë asnjë vendim dhe nuk është as në rrugë për të marrë ndonjë vendim për të hequr dorë nga ndërtimi i kapaciteteve zgjeruese me termocentralin 'Kosova e re'. Sikur është në programin qeverisës 2020-2023, qeveria do ta rishikojë projektin e termocentralit 'Kosova e re'. Këto janë modalitete që po diskutohen

në secilin instancë dhe për secilin vendim që merret do të jemi transparentë me publikun dhe do t'ju informojmë", thotë Haxha. Kontrata në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Contour Global ishte nënshkruar në vitin 2017, ndërkohë që përgatitjet për këtë projekt kishin filluar qysh në vitin 2001. Termocentrali 'Kosova e Re' ishte paraparë të fillojë së ndërtuari këtë vit, ndërsa të vihet në punë në vitin 2023 dhe ndërtimi i tij do të kushtonte 1.3 miliard euro.

## INDEP- Termocentrali 'Kosova e re', projekt i vdekur

Por, ndërtimi i termocentralit 'Kosova e re' është kundërshtuar nga përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët në vazhdimësi e kanë konsideruar si projekt të dëmshëm për mjedisin. Thëngjilli konsiderohet se krijon ndotje të lartë të ajrit.

Dardan Abazi, hulumtues i lartë në Institutin për Politika Zhvillimore (INDP), thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Qeveria e Kosovës duhet të ndjekë rrugë të tjera për kapacitetet energjetike dhe të heqë dorë nga kapacitetet energjetike me thëngjill. "Ne kemi kërkuar një qartësim të pozicionit të Qeverisë së Kosovës lidhur me termocentralin 'Kosova e re' dhe, sipas disa njoftimeve që i kemi nga brenda, qeveria ende është duke u orvatuar që të vë një komunikim më këtë kompani (Contour Global) dhe të shoh se cilat janë modalitetet në mënyrë që të vazhdohet me këtë projekt. Për neve ky projekt është i vdekur", thotë Abazi. Sipas tij, rruga që duhet ndjekur Qeveria e Kosovës është shqyrtimi i mundësive përmes një modelimi të përgjithshëm të sistemit energjetik të Kosovës për të parë nëse ka potencial të caktuar për investime të mëtutjeshme energjetike. "Kemi nevojë për kapacitete të reja energjetike, por ne konsiderojmë se këto kapacitete duhet të vijnë nga burimet e ripërtërishme të energjisë, qoftë përmes ngritjes së investimeve në fushën e masave stimuluese nga energjia e ripërtërishme apo përmes fuqizimit të mekanizmave të vet prodhimit

nga ana e konsumatorëve përmes paneleve solare dhe pajisjeve të tjera të cilat ndikojnë në uljen e konsumit dhe shtimit të prodhimit të energjisë", thotë Abazi.

## Gazsjellësi, mundësi për ta eliminuar energjinë me thëngjill

Në anën tjetër, një projekt i gazsjellësit Greqi - Maqedoni - Kosovë konsiderohet si mundësi e mirë për kapacitete të reja energjetike. Ministri i Infrastrukturës në Qeverinë e Kosovës, Arban Abrashi, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" pati thënë se një projekt i cili është diskutuar në takimet që kanë pasur në Uashington më 3 dhe 4 shtator, kur është arritur marrëveshja për normalizim të marrëdhënieve ekonomike Kosovë - Serbi, ka qenë edhe linja e gazsjellësit. "Një projekt që nuk po përmendet e që ka peshë të madhe në të bërit biznes në Kosovë dhe në përgjithësi në zhvillimin e vendit, është linja e gazsjellësit. E kemi diskutuar edhe më herët, por është një projekt që ka qenë pjesë e diskutimeve dhe e investimeve të ShBA-së në Kosovë. Ideja themelore është të ndërtohet gazsjellësi nga Greqia në Kosovë, ndërsa lidhja jonë të bëhet në Shkup", ka thënë

Abrashi.

Dardan Abazi, hulumtues i lartë në INDEP, thotë se pikërisht edhe ky projekt i gazsjellësit duhet të shqyrtohet nga Qeveria e Kosovës në mënyrë që t'i iket energjisë nga thëngjilli. "Kosova duhet të lirohet nga burimet ndotëse të energjisë dhe të kalojë në energjinë e ripërtërishme dhe alternativa të tjera. Pastaj, po ashtu, t'i shohim mundësitë qoftë edhe duke i konsideruar investimet e fundit të paralajmëruara në zotimet e Uashingtonit. Të shihet se cilat janë opsionet që ofrohen", thotë Abazi.

Kosova ka konsideruar në vazhdimësi ngritjen e kapaciteteve energjetike përmes thëngjillit, pasi që ka më shumë se 10 miliardë tonë thëngjill dhe, si e tillë, është vendi i pestë në botë për nga sasia e këtij resursi. Kosova, ndërkohë, vazhdon të përballet me mungesë të energjisë elektrike.

Problemi me furnizim stabil me energji elektrike në Kosovë së fundi është theksuar edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për Klimën e Investimeve të publikuar më 9 shtator. Sipas këtij raporti, Kosova ka potencial për të tërhequr investime të huaja direkte, por një nga problemet që pengon ardhjen e investitorëve të huaj në Kosovë është edhe furnizimi jo i besueshëm i energjisë.

## Në Magurë të Lipjanit përrurohet shkolla e re

LIPJAN, 14 SHTATOR (ER) - Ditën e parë të vitit të ri shkollor 2020/2021 nxënësit e Magurës e kanë nisur në shkollë të re. Në përrurimin e kësaj shkolle që mban emrin e dëshmorit "Haradin Bajrami", morën pjesë kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, kryetari i komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti dhe ministri i Arsimit, Ramë Likaj. Kryetari i komunës, Imri Ahmeti, ka falënderuar kryeministrin Hoti për

ndihmën e dhënë për ndërtimin e kësaj shkolle. Ai ka thënë se ishte Hoti në cilësinë e ministrit të Financave në qeverinë Mustafa, i cili i kishte dhënë lajmin për nderimin e kësaj shkolle dhe tani ndihet i lumtur që ai po merr pjesë në këtë përrurim në cilësinë e kryeministrin. "Është rast i veçantë sepse po përrurohet një objekt i veçantë, një objekt model i kompletuar me gjithë infrastrukturën. Në raport me një objekt që deri më tani e

kemi pasur, vërtet jep mundësi të mira që nxënësit tonë të jenë më komod dhe të kenë një shkallë më të lartë të mësimnxënies", është shprehur Ahmeti. Ndërsa kryeministri Hoti në fjalën e tij ka përrgëzuar kryetarin Imri Ahmeti për punën e bërë në kompletimin e kësaj infrastrukture. Duke uruar nxënësit për këtë shkollë, ai ka bërë thirrje që të respektohen masat në mënyrë që mësimi të vazhdojë.



## 'Yess Pharma' dhuron maska për të gjithë mësimdhënësit e Drenasit



DRENAS, 14 SHTATOR (ER) - Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2020/21, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim drejtorin e kompanisë "Yess Pharma", Armend Ramadani dhe përfaqësuesin e kësaj kompanie, Arlind Basholli, të cilët i kanë dhuruar 1 000 maska shumëpërdorimëshe për të gjithë mësimdhënësit e shkollave të Komunës së Drenasit. Drejtori i kompanisë "Yess Pharma", Armend Ramadani, ka thënë se ky donacion i jepet

Komunës së Drenasit për të gjithë mësimdhënësit, pasi që Drenasi ka rezultuar me performancën më të mirë nga të gjitha komunat për vlerësimin e fundit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal. Kryetari Lladrovci ka falënderuar Armend Ramadani dhe Arlind Bashollin për këtë donacion të ofruar dhe ka përrgëzuar për maskat shumëpërdorimëshe dhe cilësore që i kanë sjellë donacion. Kryetari Lladrovci tha se ky donacion është shumë i

mirëseardhur sidomos në fillimin e vitit të ri shkollor për ta parandaluar përhapjen e virusit Covid-19. Maskat do të dhurohen për të gjithë mësimdhënësit e institucioneve edukative-arsimore në Komunën e Drenasit dhe vlera e donacionit është 2 500 euro. Maskat janë të cilësisë së lartë dhe janë shumëpërdorimëshe të cilat ndihmojnë për luftimin dhe parandalimin e virusit Covid-19 dhe janë të lehta për ta mbajtur mësimin pa pengesa nga mësimdhënësit.

## Vazhdon thirrja publike për mbështetjen e bizneseve të reja dhe të vogla në Skenderaj

SKENDERAJ, 14 SHTATOR (ER) - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm në Komunën e Skenderajt, ka hapur thirrjen publike për financimin e bizneseve fillestare "Start Up" si dhe për bizneset e vogla. Ky program "Start Up" dhe bizneset e vogla është i krijuar në atë formë që të ndihmojë këto biznese për zgjerimin e veprimtarisë së tyre, po ashtu edhe për mbështetjen e ideve konkrete të biznesit. Komuna e Skenderajt përmes

kësaj mbështetje synon që të gjenerojë vende të reja të punës për qytetarët e komunës, duke vendosur në theks të veçantë gjininë femërore si dhe të rinjtë. Po ashtu, synohet edhe zhvillimi i ndërmarrësisë tradicionale të komunës, ku zhvillimi i kësaj fushe ndihmon drejtpërdrejt në zhvillimin e ekonomisë së Skenderajt. Thirrja publike për mbështetjen e bizneseve të reja dhe të vogla në Skenderaj është e hapur deri më 18 shtator.



## Në Gjilan katër mësimdhënëses pozitivë me Covid-19

GJILAN, 14 SHTATOR (ER) - Komiteti i emergjencave për parandalimin e pandemisë globale ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt dhe pas analizimit të gjendjes së përgjithshme ka bërë me dije se janë kthyer rezultatet e testimit të mësimdhënëseve dhe nga të gjitha testimet e bëra, vetëm katër raste janë konfirmuar pozitive të cilët janë duke u trajtuar nga mjekët. Në fjalën e tij, në konferencën me gazetarë, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar të gjitha institucionet shtetërore që me punën e tyre janë të vendosur për ta garantuar procesin mësimor në shkolla, ndërsa gjendja me virusin Covid-19 në Gjilan është e qetë dhe

vazhdimisht në rënie. "Gjendja është e qetë dhe nën kontroll të vazhdueshëm të ekipeve shëndetësore. Deri tani nga rezultatet e pranuar kemi katër mësimdhënëses që kanë rezultuar pozitivë dhe menjëherë janë marrë masat e nevojshme sipas protokollit shëndetësor dhe në bazë të planifikimit të MASHT-it. Në gjendjen e përgjithshme, Gjilani vazhdon t'i ketë 119 raste aktive me Covid-19, nga gjithsej 936 raste pozitive sa kishim që nga 13 marsi e deri më sot. 776 pacientë janë shëruar plotësisht dhe për fat të keq 41 pacientë kanë humbur betejën me virusin Covid-19. Mostra në pritje janë gjithsej 33, ndërsa të hospitalizuar i kemi 24 pacientë, të cilët janë



nën monitorim të vazhdueshëm", ka thënë kryetari Lutfi Haziri. Apeli i përbashkët është për

kujdes maksimal dhe parandalim të virusit, duke përdorur masat mbrojtëse e deri te vetizolimi nëse paraqiten simptomat,

sepse vetëm në këtë formë mund të garantohet shëndeti publik dhe parandalimi i përhapjes së virusit.

## Shpallen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në Mal të Zi

PODGORICË, 14 SHTATOR - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Malin e Zi ka shpallur të hënën rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 30 gushtit. Në bazë të rezultateve, Partia Demokratike e Socialistëve, e presidentit Millo Gjukanoviq, ka fituar 30 vende në përbërjen e re të parlamentit, koalicioni "Për Ardhmërinë e Malit të Zi", 27 deputetë, koalicioni "Paqja është kombi ynë" 10 dhe koalicioni "E zeza në të bardhë" katër vende.

Partia Boshnjake dhe Social-Demokratët fituan nga tri vende secila, Partia Socialdemokrate dy, dhe nga një vend në parlament e kanë fituar: Lista

Shqiptare "Nik Gjeshaj-Genci Nimanbegu" dhe koalicioni "Bashkë një za".

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, brenda 15 ditëve, kryetari i përbërjes së vjetër të parlamentit, Ivan Brajoviq, thërret seancën e parë të përbërjes së re të Parlamentit të Malit të Zi.

Presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanoviq, propozon emrin e kryeministrit të ri në afat prej 30 ditësh që nga konstituimi i parlamentit.

Zgjedhjet në Mal të Zi u mbajtën më 30 gusht. Për herë të parë pas tri dekadash, Partia Demokratike e Socialistëve e presidentit Millo Gjukanoviq ka humbur shumicën në



parlament.

Zgjedhjet u fituan nga partitë opozitare që konsiderohen si pro-serbe dhe pro-ruse.

Mali i Zi, përndryshe, konsiderohet lider në procesin e integritimit evropian. Ai ka qenë

vendi i parë i Ballkanit Perëndimor që ka nisur negociatat e pranimit me Bashkimin Evropian në qershor të vitit 2012.

Liderët e tri subjekteve politike të koalicionit opozitar, të cilat e

kanë fituar shumicën në zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi, në një konferencë për media më 9 shtator kanë prezantuar parimet mbi të cilat do të mbështetet qeveria e ardhshme dhe të cilat nënkuptojnë bashkëpunimin me aleancën e NATO-s, mosvënien në diskutim të njohjes së Kosovës dhe që përjashtojnë mundësinë e ndryshimit të simboleve shtetërore të Malit të Zi.

Parimet e marrëveshjes u shpallën nga liderët e koalicionit "Për ardhmërinë e Malit të Zi", "Paqja është kombi ynë" dhe "E zeza mbi të bardhë" e Zdravko Krivokapiqit, Aleksa Beçiqit dhe Dritan Avazoviqit.

## Maqedonia e Veriut regjistron 37 të infektuar me koronavirus dhe katër viktima

SHKUP, 14 SHTATOR - Maqedonia e Veriut të hënën regjistroi 37 të infektuar me koronavirus, shifër kjo më e ulëta në dhjetë ditët e fundit. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, në 24 orët e fundit kanë humbur jetën katër pacientë me koronavirus, me të cilët numri i

përgjithshëm i viktimave nga Covid-19 arrin në 652. Në raportin e ministrisë, po ashtu, bëhet me dije se në 24-orëshin paraprak janë shëruar edhe 131 pacientë.

Rastet e reja të raportuara i referohen testimit të 464 mostrave.

Maqedonia e Veriut, në total, ka diagnostikuar 15 827 raste me koronavirus.

Numri i rasteve aktive aktualisht qëndron në 1 860. Shkupi, Kumanova, Prilepi dhe Tetova janë qytetet me numrin më të lartë të të infektuarve, viktimave dhe të rasteve aktive.



## Berluskoni për koronavirusin: Ndër përvojat më të vështira në jetë



ROMË, 14 SHTATOR - Ish-kryeministri italian Silvio Berlukconi është larguar të hënën nga spitali, 11 ditë pasi ka nisur trajtimin për koronavirus. Ai e ka përshkruar këtë periudhë si "ndoshta më të vështirën në jetën e tij".

Manjati mediatik, 83-vjeçar, që ka rezultuar pozitiv në testimet për koronavirus pasi është kthyer nga pushimet, është shtrirë në spitalin San Raffaele

në Milano më 3 shtator. "Tri ditët e para kanë qenë jashtëzakonisht të vështira", u ka thënë ai gazetarëve teksa është liruar nga spitali.

Dy fëmijët e tij, vajza Barbara 36-vjeçare dhe djali Luigi, 31-vjeçar, po ashtu kanë qenë në kontakt me virusin. "Ka qenë e vështirë. Duke iu falënderuar mjekëve, unë kam tejkaluar atë që ndoshta ka qenë përjetimi më i rëndë i jetës sime".

Berluskoni ka qenë kryeministër italian tri herë gjatë periudhës 1994-2011.

Miliarderi italian ka insistuar këtë muaj se do t'i vazhdojë aktivitetet e tij politike, pavarësisht testimit pozitiv për koronavirus.

Zgjedhjet rajonale do të mbahen këtë fundjavë në Itali ashtu sikurse referendumi për zvogëlimin e numrit të deputetëve në parlament.

## Yoshihide Suga, një hap afër pozitës së kryeministrit të Japonisë

TOKIO, 14 SHTATOR - Partia japoneze në pushtet, Partia Liberal-Demokrate, e ka përzgjedhur të hënën shefin e saj të kabinetit, Yoshihide Suga, si lider të ri, duke çuar një hap tutje synimin e tij për ta zëvendësuar Shinzo Aben për pozitën e kryeministrit. Suga ka fituar lehtë zgjedhjet, duke siguruar 377 nga 534 votat valide të ligjvënësve të partisë dhe përfaqësuesve rajonalë.

Rivalët e tij, ish-ministri i Mbrojtjes, Shigeru Ishiba dhe shefi për politika në Partinë

Liberal-Demokrate, Fumio Kishida, kanë mbetur mbrapa.

Marrë parasysh shumicën që siguron partia e tij në parlament, Suga pritet t'i fitojë votat e mjaftueshme të mërkurën dhe të bëhet kryeministër, pasi Abe ka dhënë dorëheqje për arsye shëndetësore.

Si këshilltar i deritashëm qeveritar, 71-vjeçari Suga konsiderohet si figurë stabile dhe vazhdues i politikave të Abes. Ai ka thënë specifikisht se kandidatura e tij është motivuar nga dëshira për

ta vazhduar programin e kryeministrit në shkuarje.

Abe, që ka thyer rekord si kryeministri që ka shërbyer më së gjati në Japoni para se të largohej nga zyra, nuk ka përkrahur publikisht asnjë kandidat që ka garuar për shef të ekzekutivit. Si kryeministër, Suga do të përballet me një seri të sfidave, duke përfshirë luftimin e koronavirusit dhe ringjalljen e ekonomisë së tretë në botë, e cila ka qenë në recesion edhe para pandemisë.



# POLLATA E MUNOLLËVE LEGJENDARË

**Ismet SYLEJMANI**

**OPINION**

E HËNË, 17 SHTATOR 2018 **EPOKA E RE** 13

## POLLATA LEGJENDARE

Sot 30 vjet Kosova nisi ndryshimin e sajë në Pollatë!

Sot 30 vjet në Pollatën Legjendare, eskadronet e vdekjes të ushtrisë dhe policisë serbe nuk kaluan dot! Sot 30 vjet në Pollatën Legjendare të Krahinës lavdimadhe të Llapit, tanket, auoblindat, picgauerat dhe nivat e zastavat serbe nga pushkët dhe bombat, nga baroti dhe zjarri i luftës për liri e çlirim të Munollëve, për orë të tëra u ndaluan!

Kordonët dhe rrahët e zingjirit serb jo vetëm nuk levizën përpara, por u kthyen mbrapasht dhe nga pushket e Heronjëve të Kombit Besim Latifi e Skender Munolli, por edhe të tjerë pjestarë e luftetarë kreshnik që mbetën gjallë dhe i shpëtuan rrethimit dhe vrasjeve të sigurta, si luftetari e trimi heroik Ibush Munolli, por edhe Muhamet Latifi, Munoll Munolli, Sejdi Zeneli e të tjerë burra e gra të Munollëve trima e sypatrembur, u kallën flakë dhe u goditën e pësuan humbje të mëdha!

Pollata e Llapit është Prekazi i Drenicës, është Glogjani i Deçanit!

Pollata e Llapit është sikur betejat lavdimëdha të UÇK-së, por me një dallim të madh!

Pollata ia drejtoi pushkën Serbisë pushtuese në vitin 1990 e UÇK luftoi me 1999, por të gjithë shokët dhe bashkëveprimtarët e dijmë se Pollota dha shkëndijat e para me argumente në teori dhe praktikë të përgaditjeve të fillimit të organizimit për themelimin e UÇK-së!

Pollata e Llapit është fortesë e shkëmbi i madh i Atdheut e Kombit tonë!

Pollata radhitet në mesin e hallkave të mëdha e të arta të luftës e qendresës madhore kombëtare me armë në duar kundër Serbisë!

Pollata me qendresën e sajë titanike u shënderru në kala heroike, që për orë të tëra i vuri fre ushtrisë së Jugosllavisë dhe Serbisë, prandaj me të drejtë mund dhe duhet të radhitet me vendluftimet dhe arenat e



**Ismet SYLEJMANI**

*E dashur dhe shumë e nderuar familja Munolli e Pollatës! Të dashura dhe të nderuara familje të heronjëve të deshmëve Besim Latifi dhe Skender Munolli!*

*Të dashur dhe shumë të nderuar familjarë të heronjëve dhe deshmëve të Atdheut! Të nderuar të pranishëm, veprimtarë, patriot ish - të burgosur politik, luftetarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, komandantë!*

*Është knaqësi dhe nderë i madhë të flasësh në Pollatë përpara këtij vendi që është deshmi e gjallë e luftës dhe heroizmit të pashembullt të vitit 1990!*

*Është thënë dhe shkruar gjithmonë nëpër histori se çdo pëllëmbë e Atdheut tonë, është histori e madhe dhe e lavdishme!*

*Por ky vend këtu është histori që na ka mësuar dhe na ka bindur se lufta për lirinë e popullit shqiptar është e mundshme dhe çlirimi i Atdheut bëhet vetëm me luftë të armatosur!*



**Besim Latifi**

**Skender Munolli**

Krahina e Llapit nga ky vend e ka marrë nismen e parë, se lufta kundër Serbisë bëhet me sukses

të madh por gjaku është e pashmangshme që të mos derdhet! Të gjithë e dimë se viti 1990 është vit i madh, sepse Pollata e ka shkundur përgjithmonë nga gjumi popullin dhe politikanët pacifistë, sepse pa luftë të armatosur nuk bëhet e mundshme liria dhe pavarësia e popullit tonë!

Kësaj ngjarje dhe kësaj lufte të madhe këtu të Munollëve të lavdishëm, i ka paraprirë Çeta heroike e Llapit, i ka paraprirë gjaku i derdhur për liri i Ali Ajetit, i Bedri Sokoli, i Afrim Zhitisë dhe i Fahri Fazliut! Ajo ka qenë pararendsja e bete-

jes këtu që është zhvilluar me pushkë e me bomba, me barut që është larë me gjak. Gjaku i Besimit dhe gjaku i Skenderit, ka qenë vula përfundimtare, dhe është nisur fillimi i krijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Hasan Ramandani është vazhduesi besnikë i heroizmit masiv të Munollve.

Është e pashmangshme që të mos përmendet profesori i matematikës Isuf Latifi, i cili me laps dhe me ditarë përpara nxënseve i ka braktisur ato dhe ka kapur pushken e luftës për liri, dhe lufta e Ushtrisë Çlir-

imtare të Kosovës, këtu në këtë vendë ka pasur kuptim më shumë se kudo, sepse e ka lidhur Demë Ahmetin dikur, e ka lidhur folenë e të burgosurve politikë ku ka qendruar edhe Metush Krasniqi këtu, e ka vazhduar me luftën heroike të Munollëve, kjo ngjarje e 28 viteve që koincidon me ditën sot dhe ditën atëherë, neve na obligon shumë!

Munollëve dhe Pollatës, populli shqiptar jo vetëm që duhet t'iu përulet përgjithmonë, por edhe ju ka borgj!

Lavdi e përjetshme! Nderë dhe Lavdi përgjithmonë!



Pollatë, 13 shtator 2018



**AA VISION**  
**NDEROHET 28 VJETORI I RËNJES HEROIKE TË HERONJËVE BESIM LATIFI DHE SKENDER MUNOLLI**

**FJALIM I ISH-ANËTARIT TË KOMITETIT DREJTUES TË LPRK-SË ISMET SYLEJMANI**

mëdha të luftëtarëve e komandantëve të popullit shqiptar kundër Serbisë pushtuese dhe për liri e çlirim të Kosovës dhe

Pavarësisë së sajë! Munollët janë lapidari i madh në tokën dhe qiellin e Atdheut! Brezat e popullit shqiptar

përgjithmonë do të nderojnë heroizmin dhe qendresën biblike të tyre! Lavdi e përjetshme gjakut të derdhur të Munollëve të

Pollatës legjendare! Lavdi Heronjëve të Kombit Besim Latifi e Skender Munolli! **Prishtinë, 13 Shtator 2020!**



ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**E jashtëzakonshme**

# Një det plot thesare e të panjohura, vajza gjen vazon e çmuar të Perandorisë Austro-Hungareze

Shumica prej njerëzve në plazh shkojnë për të marrë rreze, për t'u relaksuar apo për t'u larë në det, edhe pse sipërfaqja e tij është një botë me vete, me thesare e plot të panjohura. Dihet se deti nuk përmban vetëm rërë e gracka, por edhe objekte të çmuara që mund të kenë humbur kohë më parë nga mbretër gjatë luftërave të shumta. Një vajzë tregon përvojën e saj ndërsa po kërkonte guaska deti në plazhin në Ankaran të Sllovenisë. Ajo tha se gjeti



gota, qeramikë, monedha të vjetra, sende argjendi dhe sende të tjera mahnitëse mbi 100-vjeçare.

**BARSOLETA E DITËS**



Gjakovari i thotë gruas:

- Bëmë nervoz që të më dhembë koka.
- Pse kërkon të të dhembë koka?
- Dua ta pi një 'Paracetamol', se veç edhe sot paska afat.



**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**



**FOTO E DITES**



Të hënën në Kosovë ka filluar viti i ri shkollor 2020/2021

E rrallë

# Donte ta largonte syrin e keq, gruaja humbet të gjitha kursimet e jetës

Një banore e Luganos ka humbur të gjitha kursimet e jetës pasi u mashtrua nga disa organizata kriminale që pretendonin se ishin 'magjistare' dhe largonin syrin e keq. Gruaja 60-vjeçare donte të largonte negativitetin që ndiente në jetën e vet dhe kështu kontaktoi me 'profesorin' një lloj magjistari afrikan i cili jetonte në Paris. Ky ritual kushtonte 25.000 franga dhe e bindur se ky 'profesor' do ta ndihmojë ta zgjidhë problemin e saj, gruaja shkon tërhequr paratë dhe më pas menjëherë nis për në kryeqytetin francez. Atje asgjë nuk shkoi siç ishte planifikuar. Asnjë dhomë hoteli nuk ishte rezervuar në emrin e saj dhe shpëtimtari i saj i pretenduar nuk u paraqit në datën dhe vendin që kishin caktuar.

 <p><b>DASHI</b> Komunikimi dhe shoqëria do të jenë në gjendjen më të mirë këto ditë. Njohje të reja dhe shumë mundësi punësimi ju presin.</p>	 <p><b>DEMI</b> Në pamjen e yjeve sfera private do të jetë në rregull. Mos u ndalni para vështirësive që do të hasni, vazhdoni planet tuaja.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Do të jeni shumë i disponueshëm për të gjithë ata që kanë nevojë për ju. Sa i përket dashurisë, një histori e kaluar nuk po ju lejon ta vazhdoni jetën ashtu si dëshironi.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Në lidhje me sferën sentimentale ju do ta përmirësoni mirëkuptimin me të dashurin tuaj duke u mbështetur në kujtimet që ju prej vitesh keni mbledhur.</p>	 <p><b>LUANI</b> Nëse keni një aktivitet të pavarur, përqendrohuni shumë te komunikimi dhe do t'ia dilni mbanë.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Një qëndrim pajtues dhe pak frymë adaptimi do t'ju garantojnë qetësi dhe marrëdhënie të mira me të afërmit, miqtë dhe kolegët e punës.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Do të realizoni një projekt, të zgjidhni çështje të pazgjidhura, të kryeni negociata biznesi, të kërkontë rritje ose stimuj për angazhimin e treguar në punë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Ju do të përjetoni një interes të ripërtërirë në marrëdhëniet shoqërore. Kuriioziteti do t'ju çojë në mjedise të ndryshme më shpesh se zakonisht.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Në marrëdhëniet në çift, tërheqja është magneti që ju shtyn drejt njëri-tjetrit. Mund të jetë një natë plot pasion.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Do ta filloni ditën dhe javën me zell dhe vendosmëri, duke demonstruar cilësitë tuaja më të mira para botës.</p>	 <p><b>UJORI</b> Puna është e mirë dhe nëse nuk është shumë mirë është vetëm sepse, për t'ju tërhequr vëmendjen nga punët tuaja, familja ose çështjet sentimentale.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Ju mund t'i mbyllni marrëdhëniet në një mënyrë të shkëlqyeshme dhe të kënaqshme. Gjithashtu do të jetë dita e përkryer për të dërguar ftesa dhe për të mbledhur miq.</p>


## Halle Berry mbetet pa fjalë nga shuma që ia ofroi 'Netflix' për një projekt filmik



**D**ebutimi i saj si regjisore në filmin e metrazhit të gjatë "Bruised" është rrugës për t'u kërkuar nga Netflix për 20 milionë dollarë, shkuan "DailyMail". Kolosi i transmetimit ka hyrë në fazat e fundit të negociatave të blerjes për

filmin MMA. Ndërsa lajmet për marrëveshjen u përhapën, superylli 54-vjeçar shkroi në "Twitter" duke shkruar: "Jam pa fjalë. Faleminderit 'Netflix' për besimin në vizionin tim. Mezi pres që të gjithë të shohim më në fund BruisedTheMovie".

## Justini pozon në përfaqim të gruas, e gjithë vëmendja është tek ajo



**J**ustin Bieber dhe Hailey Baldwin janë ndër çiftet më të komentuar të shoubizit. Dyshja që prej se e bën publike lidhjen e dashurisë nuk i ndahen njëri-tjetrit, ndërsa nuk mungojnë asnjëherë dedikimet romantike. Së fundi,

këngëtari publikoi një fotografi nga një shëtitje me varkë bashkë me gruan, teksa duket shumë i lumtur në përfaqim të saj. E gjithë vëmendja është te linjat e përsosura të modelueses, e cila i kishte veshur një palë bikini me ngjyrë të zezë.



## Kida si kameleon, ndryshon edhe një herë dukjen

**K**ida është emër shumë i suksesshëm i estradës, e cila njihet për një numër të madh projektesh muzikore. Këngëtarja së fundi ka shijuar pushimet në bregdet, menjëherë pas publikimit të këngës "Edhe sa", e cila menjëherë u shndërrua


në hit. Në klipin e asaj kënge Kidën e kemi parë si bionde, ndryshim që erdhi papritur, por që asaj i shkonte shumë dhe e komplimentuan të gjithë. Por, artistja ka vendosur që edhe një herë ta ndryshojë pamjen, duke ngjyrosur flokët me ngjyrë rozë.

## Don Xhoni zbulon hollësi rreth këngës së re



**D**on Xhoni është emër i ri në tregun e muzikës shqiptare, njëherësh shumë premtues. Reperi ka pak projekte muzikore të publikuara, por të cilat po priten mirë në publik, andaj ai ka vendo-

sur të mos ndalet. Përmes një postimi në "Instagram", Don Xhoni solli një imazh nga prapaskenat e videoklipit të ri, ndërsa bëri të ditur se kënga po vjen shumë shpejt.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Basketbollistët: Liga Unike, e mirëseardhur për talentët

### "Epoka e re"

**PRISHTINË, 14 SHTATOR** - Të enjten u nënshkrua zyrtarisht formimi i Ligës Unike mes Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëveshjen e nënshkruan presidenti i FShB-së, Avni Ponari dhe kryetari i FBK-së, Arben Fetahu. Liga do të ketë tetë skuadra, katër më të mirat nga Kosova dhe katër më të mirat nga Shqipëria. Ideja e formimit të kësaj lige ishte mirëpritur në Kosovë nga analistët, klubet dhe basketbollistët. Basketbollisti i Pejës, Dardan Berisha, ka thënë se liga e përbashkët në mes dy shteteve shqiptare përkrahet nga të gjithë. "Sigurisht se e përkrahim Ligën ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo është një ëndërr e realizuar për shumë shqiptarë. Besoj se kjo Ligë do të ishte shumë interesante dhe me interes për publikun mbarëshqiptar. Do të kishte rivalitet dhe do të ishte një risi e mirëseardhur për të gjithë ne", kishte thënë Berisha. Edhe kapiteni i Prishtinës, Edmond Azemi, që është basketbollisti me përvojën më të madhe në basketbollin e

Kosovës, e ka përkrahur ligën e përbashkët, pasi kjo ka qenë një ëndërr e të gjithë shqiptarëve. "Ideja e Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për formimin e kësaj lige është shumë e qëlluar. Të gjithë kemi pasur ëndërr për formimin e një Lige Mbarëkombëtare. Duke marrë parasysh që vështirë se edicionin e ardhshëm mund të luajmë në Evropë, kjo Ligë do të na shërbejë shumë. Gjithashtu, është shumë pozitive që ka marrë lejen nga FIBA Evropa", ka deklaruar Azemi.

Një tjetër basketbollit me përvojë në Kosovë dhe ndër më të mirët, Drilon Hajrizi, ka vlerësuar se kjo ligë duhet të shfrytëzohet që t'u jepet sa më shumë hapësirë lojtarëve të rinj. "Ideja për formimin e Ligës së përbashkët Kosovë - Shqipëri është shumë e mirë. Megjithatë, kjo ligë duhet të shfrytëzohet për t'u dhënë hapësirë lojtarëve të rinj dhe të mos jetë një ligë ku skuadrat do të synonin me çdo kusht titullin e kampionit. Basketbollistët e rinj kanë nevojë për sa më shumë ndeshje ndërkombëtare në mënyrë që të fitojnë përvojë. Kjo mund t'u ndihmojë atyre në të



ardhmen. Sa më shumë ndeshje ndërkombëtare aq më shumë përvojë do të fitojnë. Nëse u japim hapësirë lojtarëve të rinj, atëherë kjo ligë është shumë e mirëseardhur. Por, nëse garohet vetëm për titullin e kampionit, atëherë mund të kemi shumë shpenzime dhe pak përfitime", ka thënë Hajrizi.

Ndërsa Samir Zekiqi beson se klubet do ta shfrytëzojnë në maksimumin formimin e kësaj lige dhe të nxjerrin sa më shumë talentë. "Është ide shumë e mirëseardhur. Është shumë mirë që kemi më shumë ndeshje. Shpresoj se në këtë ligë do të ketë hapësirë për lojtarët e rinj e të

talentuar. Ata duhet të përkrahen maksimalisht dhe të kenë sa më shumë hapësirë. Klubet të punojnë për nxjerrjen e talenteve dhe të përfitojnë lojtari, klubi, por edhe kombëtarja", është shprehur Zekiqi.

Sipas basketbollistit Valon Bunjaku, kjo ligë do të jetë në favor të basketbollistëve, pasi do ta kenë rastin të luajnë basketbollistët e rinj. Ai ka thënë se kjo do të jetë e mirëseardhur edhe për shikuesit ku mund të arketohen. "Liga Unike mendoj se do të jetë një risi për ne basketbollistët, po ashtu edhe për shikuesit. Gjithashtu, do të

jetë në favor të basketbollistëve sepse do të ketë shumë lojërë. Qëllimi kryesor i kësaj lige do të jetë përkrahja e basketbollistëve të rinj. Skuadrat duhet t'u japin më shumë hapësirë të rinjve, që do të ishte një motivim i madh për ta sepse në vendin tonë ka shumë talentë të rinj që meritojnë përkrahje, e kjo do të kishte ndikim shumë të madh në fushën e basketbollit. Jam shumë i lumtur që erdhi një bashkëpunim i tillë dhe mendoj se do të jetë një përvojë prej më të mirave", ka pohuar Bunjaku. Ndërsa basketbollisti Bardh Rexha ka deklaruar: "Sa i përket Ligës së përbashkët, është gjëja më e mirë për basketbollistët vendorë. Edicioni i fundit ishte mjaft i suksesshëm për mua personalisht sepse jam paraqitur në të gjitha ndeshjet dhe jam afirmuar më shumë për të ardhmen. Falënderoj trajnerët dhe klubin e Rahovecit. Ideja është e qëlluar për një garë të përbashkët. Besojmë se do të luajmë pa presion në të gjitha skuadrat dhe t'u jepet më shumë përparësi lojtarëve të rinj, duke i futur në çdo ndeshje dhe duke pasur minutat e nevojshëm".

## Klubet e Superligës: Të drejtat televizive do të ndahen në mënyrë të barabartë

**PRISHTINË, 14 SHTATOR** - Skuadrat e Superligës së Kosovës janë pajtuar të ndajnë në mënyrë të barabartë fitimin që vjen nga të drejtat televizive për sezonin 2020/21, ka bërë të ditur FFK-ja. Për herë të parë Superliga do të jetë jashtë transmetuesit të deritashëm Digitalb/Supersport dhe të drejtën këtë vit e ka fituar ArtMotion që ka ofertuar me 380 mijë euro. "Klubet në mënyrë unanime vendosen për ndarjen e mjeteve në mënyrë të barabartë siç ka qenë deri më tash. Krerët e FFK-së ofruan gatishmëri maksimale për të gjitha klubet dhe së bashku u morën vesh të bëjnë më të mirën



euro për sezonin 2020/21. Këtë stinor Superliga do të ketë 10 skuadra pjesëmarrëse, që ka arritur më në fund procesin e shkurtimit të ekipeve pas shumë vitesh, ndërsa ekipet që do të garojnë për titull, dalje në Evropë dhe mbijetesë janë: Drita, Gjilani, Ballkani, Prishtina,

Feronikeli, Llapi, Trepça '89, Drenica, Besa e Arbëria. Nga skuadrat pjesëmarrëse, Arbëria është debutuese këtë stinor në Superligë - pasi që ka arritur për herë të parë ta sigurojë elitën e futbollit të Kosovës. Në anën tjetër, skuadrat e tjera duket të jenë stabile dhe pritet të jetë një luftë e madhe si për titull, po ashtu edhe për mbijetesë.

## Çyrbja përforcon Gjilanin

**GJILAN, 14 SHTATOR** - Skuadra nënkampione e Kosovës në futboll, Gjilani, ka arritur marrëveshje me futbollistin nga Shqipëria, Arbër Çyrbja. Ky i fundit me skuadrën gjilanase ka nënshkruar marrëveshje njëvjeçare. SC Gjilani do të jetë skuadra e parë e Arbër Çyrbës jashtë Shqipërisë, pasi që sulmuesi këmbëshpejtë, përveç skuadrës së Teutës, kishte luajtur

për Erzenin, Elbasanin dhe verilindorët e Kukësit. Çyrbja ishte ftuar edhe nga kombëtarja e moshave, ku ishte grumbulluar me grupmoshat U-18 dhe U-21 të Shqipërisë. "Arbër Çyrbja ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me skuadrën e Gjilanit, ku do ta mbajë atë si pjesë e kuqebardhëve për edicionin e ri garues në Superligën e Kosovës në futboll", thuhet në njoftimin e Gjilanit.



## Shqipëria zyrtarizon miqësoren me Gjibraltarin

**TI Ranë, 14 SHTATOR** - Kombëtarja shqiptare e futbollit do të zhvillojë një miqësore me Gjibraltarin më 11 nëntor 2020. Në njoftimin e FShF-së saktësohet që, sipas marrëveshjes së arritur mes dy

federatave, ndeshja do të zhvillohet në stadiumin "Elbasan Arena" dhe do të nisë në orën 19:00. Kjo do të jetë hera e parë që Shqipëria ndeshet me Gjibraltarin, si edhe miqësorja e dytë për kuqezinjët

në program. Kombëtarja shqiptare do të luajë edhe një miqësore ndaj Armenisë më 7 tetor 2020, ndeshje që do të zhvillohet në transfertë. Pas takimit me Gjibraltarin në muajin nën-

tor, përfaqësuesja kuqezi do të zhvillojë edhe dy ndeshje zyrtare të vlefshme për UEFA Nations League, ndaj Kazakistanit më 15 nëntor dhe ndaj Bjellorusisë më 18 nëntor, që të dyja në shtëpi.



## Hamiltoni: Në Mugello ishte si t'i fitoja tri gara

LONDËR, 14 SHTATOR - Lewis Hamiltoni arriti në pistën e Mugellos suksesin numër 90 në karrierën e tij, duke konsoliduar kreun e renditjes botërore (+55 pikë ndaj Valtteri Bottas dhe +80

pikë karshi Max Verstappen). Gjithsesi, fitorja në garën italiane nuk ka qenë e lehtë për pilotin britanik të Mercedesit si pasojë e aksidenteve të shumta në pistë, duke bërë që gara të niste tri herë.

"Ishte një garë e çmendur, me shumë aksidente. Ishte si të zhvilloja dhe fitoja tri gara të ndryshme nga njëra-tjetra, por pista ishte fantastike. Valtteri më vuri shpesh në vështirësi dhe nuk

ishte e lehtë ta mbaja pas. Gjithsesi, fitorja më gëzon, pasi arrij një shifër të rëndësishme. Të arrij këtu 90 fitore është diçka fantastike, kam se çfarë të tregoj", ka thënë Hamiltoni.



## Këto janë klubet e regjistruara për edicionin e ri

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Ka përfunduar afati për paraqitjen e klubeve për edicionin e ri 2020/2021 në basketboll. Edicioni i ri do të nisë në mesin e muajit tetor me ndeshjet e Superkupës për të vazhduar më pas me takimet e Superligës. Në sezonin e ri në Superligë do të garojnë tetë skuadra, kurse për një vend në "play-out" do të garojnë Trepça dhe AS Prishtina. Klubet e regjistruar për Superligë janë: Sigal Prishtina, Peja, Bashkimi, Ponte Prizreni, Golden Eagle Ylli, Rahoveci, Trepça, Vëllaznimi. Ndërkohë, për Ligën e Parë janë paraqitur: Lipjani, Marigona Hill Prishtina, Istogu, AS Prishtina, Prishtina e Re, Vushtrria, Drita, Mega Sport dhe New Basket.

Në Ligën e Dytë janë paraqitur këto skuadra: Dardanët, Dukagjini, Llapi, Borea, Gjakova, Sfera, United Basketball, Gjakova e Re, Kaçaniku dhe Fushë Kosova. Për Superligën e Femrave janë paraqitur: Bashkimi, Kosovahome Prishtina, Penza, Trepça, Vëllaznimi, Kastrioti. Për Ligën e Parë të Femrave janë paraqitur: Kerasan Prishtina, Drita, United Basketball, Kaçaniku, Sfera, Vushtrria, Junior 06 dhe Istogu. Lista e ekipeve të paraqitura për kategoritë e reja: LIGA U18: Sigal Prishtina, Peja, Ponte Prizreni, Bashkimi, Rahoveci, Golden Eagle Ylli, Trepça, Vëllaznimi, Peja DT, Ylli 04, Gjinnazisti, M Junior Prishtina,



Vushtrria Basket, Istogu, RBA, Prishtina e Re, Marigona Hill Prishtina dhe Megasports. Liga U16: Sigal Prishtina, Peja, Ponte Prizreni, Bashkimi, Rahoveci, Golden Eagle Ylli, Trepça, Vëllaznimi, Sfera, Mitrovica, Junior 06, M Junior Prishtina, Vushtrria Basket, Golden Basket, Drita, Lipjani, Prishtina e Re, Llapi, Marigona Hill Prishtina, Megasports dhe Istogu. Liga U14: Sigal Prishtina, Peja, Ponte Prizreni, Bashkimi, Rahoveci, Golden Eagle Ylli, Trepça, Vëllaznimi, Peja DT, M

Junior Prishtina, Vushtrria Basket, Golden ISP, Lipjani, Prishtina e Re, Marigona Hill Prishtina dhe Megasports. Liga U12: Sfera, Peja DT, Ylli 04, Trepça, Junior 06, Vushtrria Basket, Prishtina e Re, Marigona Hill Prishtina, Megasports, Istogu, M Junior Prishtina dhe SHB Halit Hoxha. Liga U14 (Vajzat): Junior 06 dhe Kerasan Prishtina. Liga U16 (Vajzat): Peja DT, Junior 06, Trepça, Vushtrria Basket, United Basketball, Kerasan Prishtina dhe Drita.

## Denveri barazon gjithçka ndaj Clippersave, finalistit vendoset në ndeshjen e shtatë

ORLANDO, 14 SHTATOR - Denver Nuggets ka fituar edhe ndeshjen e dytë radhazi ndaj Los Angeles Clippersit për ta barazuar serinë në 3-3. Clippersat kishin epërsi të lartë prej 16 pikëve pas dy çerekëve të parë, por në fund e humbën takimin me 13 pikë epërsi 111:98. Qendra Nikola Jokic ishte më i miri te Nuggets, ku e mbylli takimin me 34 pikë, 14 kërcime e shtatë asistime. Me lojë të mirë u dallua edhe Jamal Murray që shtoi 21 pikë si dhe Garry Harris me 16 të tjera. Paul George me 33 pikë ishte më efikas te Clippers, ndërsa Kawhi Leonard shtoi 25 të tjera, por që nuk mjaftuan për fitore. Tani finalistit i Konferencës së



Perëndimit do të zhvillohet në ndeshjen e shtatë e cila zhvillohet të mërkurën pas mesnate. Kujtojmë se fituesi i këtij dueli në

finale do të përballet me Los Angeles Lakersin që eliminoi pa problem Houston Rocketsin me rezultat 4-1.

### SHKURT

#### Jones përforcon KB Ponte Prizreni

Skuadra e Prizrenit në basketboll po vazhdon prezantimin e ardhjeve të reja. I radhës është basketbollisti amerikan, Justin Jones. "Justin Jones i gjatë 1.85 cm luan në pozitën e fundorit. Amerikani vjen nga liga NCCA II, ku skuadra e tij e fundit ishte PNC dhe kishte mesatare prej 19 pikëve për ndeshje", thuhet në njoftimin e Ponte Prizrenit. Për Prizrenin ky është përforcimi i tretë i huaj pasi më parë kanë prezantuar edhe ardhjet e Josh Martin e Ty Nicholas.

#### Fritz: Aston Villa e deshifron Rashicën

Ish-mbrojtësi anësor i Werder Bremenit, Clemens Fritz, aktualisht në rolin e drejtuesit të skuadra bardheshile, ka konfirmuar interesimin e Aston Villas për Milot Rashicën, për të cilin ka shumë kërkesa në merkato, por në drejtim të Werder Bremenit ende nuk ka mbërritur oferta e duhur. "Mund ta konfirmoj që kemi qenë në kontakt me Aston Villën, por ende nuk ka asgjë konkrete. Ka disa kërkesa për të dhe jemi në komunikim të vazhdueshëm me menaxherin e tij", u shpreh Fritz. Për kartonin e 24-vjeçarit, gjermanët këmbëngulin te shifra e 20 milionë eurove, ndërsa sipas raporteve të ndryshme, Aston Villa është e gatshme të shpenzojë deri në 18 milionë, shifër kjo që për momentin nuk përmbush kërkesat e Werderit.

#### Zbulohet e ardhmja e Hysajt

Elseid Hysaj me shumë mundësi do të vazhdojë të jetë pjesë e Napolit dhe rinovimi i kontratës është gati. Mbrojtësi 26-vjeçar ka edhe një vit kontratë me Napolin, kështu që klubi duhet të marrë një vendim sa më shpejt për futbollistin në mënyrë që të mos e humbasë me parametra zero në fund të sezonit. Megjithatë, sipas asaj që shkruan "CalcioNapoli24.it", situata e mbrojtësit që shihej larg Napolit ku luan nga 2015, ka ndryshuar falë trajnerit Gatuzo. Ky i fundit dëshiron ta ketë Hysajn në ekipin e vet dhe e ka bindur atë ta rinovojë kontratën. Tashmë palët janë optimiste për rinovimin e kontratës deri në vitin 2025.

#### Koeman e dëshiron Salahin te Barça

Ish-futbollisti i Ajaxit, Sjak Suart, ka thënë se trajneri Ronald Koeman e dëshiron yllin e Liverpoolit, Mohamed Salah, te Barcelona. "Kam informacione që Koeman e do shumë Salahun te Barcelona, por edhe Salah do të donte të transferohej aty. Nuk mund të them asgjë më shumë. T'ia lëmë kohës", ka thënë Suart.

#### Alvaro, Neymarit: Mësohu të humbësh

Alvaro Gonzalez ka mohuar pretendimet e Neymarit. Braziliiani akuzoi mbrojtësin spanjoll për racizëm në ndeshjen e mbrëmjes së kaluar mes PSG-së dhe ekipit të Andre Villas-Boas, që triumfoi 0-1 në kryeqytet. Një sherr i madh shpërtheu në minutat shtesë, duke detyruar gjyqtarin t'ua tregonte kartonin e kuq pesë lojtarëve, teksa përplasja më e madhe ndodhi mes Neymarit dhe Alvaros. "Nuk bëhet fjalë për racizëm. Karriera ime ka qenë e pastër deri tani, kam pasur shumë kolegë dhe shokë me ngjyrë gjatë përditshmërisë. Ndonjëherë, duhet të mësosh të humbësh dhe t'ia lësh fushës atë çfarë ndodh aty. Tri pikë të pabesueshme. Forca Marseille! Falënderoj familjen e Marseilles", ka shkruar 30-vjeçari spanjoll.



**DREJTORIA E ARSIMIT**

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës neni 5 pika e, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës neni 35, në bazë të normativit nr.10/2018 të MASHT dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr 07/2017, për Rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë këtë :

**KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRA TË PUNËS NË KOHË TË CAKTUAR**

- SHFMU "Agim Ramadani" në Zhegër Një Edukatorë/parafillor/parashkollor ( me organizatën Save the Children)
- Edukatore parafillor/parashkollor që do të punojë me orar të plotë me fëmijët e moshës 3-5 dhe 5-6 në Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme me Bazë në Komunitet ( KZHFHBK) në kuadër të SHFMU "Agim Ramadani" në fsh.Zhegër. SCiK do ta bëjë kompensimin e pagës mujore për Edukatoren Parafillor/Parashkollor nga dita emërimit deri më 30 qershor 2022 dhe më tej procedohet sipas Marrëveshjes mes DKA Gjiçan dhe SCiK për projektin Kujdesi dhe Zhvillimi gjatë Fëmijërisë së Hershme.

**Qëllimi:** Edukatore parafillor/parashkollor do të punojë me orar të plotë me fëmijët e moshës 3-5 dhe 5-6 vjeç në SHFMU "Agim Ramadani" në Zheger.

**Detyrat dhe roli**

- 1.Puna me fëmijë**
- Organizon mësimin sipas kurrikulës së Edukimit Parashkollor dhe dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët e moshës 3-6 vjeç;
  - Lehtëson të nxënëit e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç dhe i angazhon ata në aktivitete kuptimplota dhe adekuate për moshë çdo ditë sipas orarit të caktuar në SHFMU "Agim Ramadani" në Zheger;
  - Lehtëson të nxënëit dhe zhvillimin e fëmijëve të moshës 3-5 vjeç dhe i angazhon ata në aktivitete kuptimplota dhe adekuate për moshë sipas orarit të caktuar në SHFMU "Agim Ramadani" në Zheger;
  - Përdor një sërë metodash që u përshtaten rrethanave dhe nevojave të fëmijës në kontekstin e pedagogjisë ndërvepruese;
  - Përforon lidhjet mes fushave të Kurrikulës, si dhe nxit të nxënëit e integruar;
  - Në punën e përditshme me fëmijë promovon dhe integron vlerat në lidhje me të drejtat e njeriut dhe edukimin për qytetari demokratike; edukimin mbi paqen; edukimin për zhvillim të qëndrueshëm; barazinë gjinore; mirëkuptimin ndërkulturor; shkathtësitë jetësore; edukimin shëndetësor; edukimin ekonomik dhe ndërmarrës; edukimin për media; TIK-un dhe mësimin elektronik;

- Identifikon problemet/vështirësitë në të nxënëit e fëmijëve dhe ofron mbështetjen e duhur;
- Përcjell dhe dokumenton përpunimin e fëmijëve duke shfrytëzuar instrumentet specifike për monitorimin dhe dokumentimin e zhvillimit të fëmijëve dhe aplikon vlerësimin formativ nga perspektiva e ofrimit të udhëzimeve, këshillave, motivimit dhe përkrahjes për fëmijët;
- Organizon dhe merr pjesë me grupin e fëmijëve në ngjarjet dhe aktivitetet kulturore të cilat organizon shkolla (programe, ekspozita, ekskursione dhe manifestime të tjera);

**2.Puna me prindër**

- Komunikon rregullisht me prindërit dhe mban ata të informuar në lidhje me pritjet dhe aktivitetet e programit;
- Ndanë informata me prindërit lidhur me angazhimin e fëmijëve në aktivitetet shkollore dhe marrëdhëniet sociale, suksesin dhe zhvillimin e tyre;
- Diskuton përpunimin e fëmijëve me prindër dhe këshillon ata në lidhje me aktivitetet që ndihmojnë zhvillimin e fëmijëve;
- Organizon dhe merr pjesë në aktivitetet joformale të komunitetit si: takimet e nënave me fëmijët 3-5 vjeç dhe të tjera.
- Organizon takime individuale dhe grupe me prindërit sipas nevojës dhe rregullave të shkollës;

**3.Puna me kolegë (bashkëpunëtorë)**

- Merr pjesë në zhvillimin e planeve e programeve specifike edukative dhe materialeve mësimore përkatëse, si dhe në zhvillimin e planeve fleksibile individuale, në përputhje me parimin e autonomisë së shkollës dhe institucioneve parashkollore;
- Në bashkëpunim me edukatorin/en parashkollor/e mbështetës/e (mobilizues/e i/e komunitetit) mbështet organizimin dhe realizimin e sesioneve mujore për një grup të nënave dhe fëmijëve 3-5 vjeç në SHFMU "Agim Ramadani" në Zheger;
- Reflekton rregullisht për punën dhe ndanë informata me kolegët lidhur me suksesin, përpunimin dhe jetën e fëmijëve;
- Inkurajon diskutimin dhe bashkëpunimin midis mësimdhënësve, komunitetit, prindërve dhe fëmijëve;
- Bashkëpunon me personelin edukativ të shkollës dhe me hierarkinë institucionale;
- Ndihmon Save the Children dhe personelin e shkollës në rehabilitimin dhe rimobilimin e hapësirës për shërbimet e KZHFH dhe e adapton atë për punë edukative;

**4.Puna me ofrues të shërbimeve tjera (shëndetësore dhe të mirëqenies sociale)**

- Bashkëpunon me ofrues të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve sociale të cilët do të kontribuojnë në planifikimin dhe ofrimin e sesioneve mujore për një grup të nënave dhe fëmijëve të moshës 3-5 vjeç në SHFMU "Agim Ramadani" në Zheger;
- Referon fëmijët me vështirësi shëndetësore dhe/ose sociale dhe diskuton problemet e identifikuar dhe nevojat e fëmijëve me profesionistët përkatës;

**5.Zhvillimi Profesional**

- Ndjekë trajnimet e nevojshëm që lidhen me Zhvillimin dhe Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme dhe shërbimet që e mbështesin atë, të ofruara nga MASHT, Save the Children dhe organizatat të tjera.
- Angazhohet në punë ekipore dhe merr pjesë në komunitetet e grupeve profesionale brenda dhe jashtë institucionit përkatës;
- Në mënyrë indirekte merr pjesë në aktivitetet jashtë mësimore dhe jashtëshkollorë;
- Kryen dhe punë tjera që i caktohen.

**6.Raportimi**

- Raporton në baza të rregullta sipas formatit të caktuar të raportimit tek organi kompetent të përcaktuar nga DKA, që do të vihet në dispozicion edhe për Save the Children.

**7.Menaxhimi**

- Edukatore parafillor/parashkollor do të punojë nën menaxhimin e menaxherit të linjës sipas përcaktimit nga DKA, në bashkëpunim me Save the Children.

**Edukatore parafillor – kualifikimet dhe shkathtësitë e nevojshme:**

**Kualifikimi për Edukatore :** kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativet të MASHT-it në fuqi.

- Të ketë njohuri për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme, të drejtave të fëmijëve dhe të mbrojtjes së fëmijëve.
- Shkathtësi që të punojë në mënyrë të përshtatshme, fleksibile dhe efektive në punë ekipore.
- Të ketë aftësi në përdorimin e programeve kompjuterike.
- Të ketë kreativitet, strategji dhe metoda bashkëkohore të mësimdhënies.
- Dëshmitë për trajnimet e vijuar për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme janë përparësi.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it, nr. 8/2010,në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

**Sqarim:**

Për këto vende të punës, kandidatët duhet t'i nënshtrohen testit me shkrim. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë, menjëherë pas mbylljes së konkursit.

**Vërejtje:** Për shkak të rrethanave të Pandemisë – Covid 19, Testi me shkrim dhe Intervista me gojë do të realizohen sipas Rekomandimeve dhe Udhëzimeve të Qeverisë IKSH (Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik) dhe MSH (Ministrisë së Shëndetësisë).



**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

- Melisa Statovci shpall të pavlefshme dëftesën si dhe diplomën e shkollës së mesme "Ahmet Gashi" Prishtinë.
- Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxe-hje qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E ZVEÇANIT

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 te Ligjit te punes nr. 03/L-212, nenit 3. paragrafi 1. te Udhëzimit Administrativ per rregullimin e procedurave per themelimin e marredhenies se punes ne sektorin publik (Nr.07/2017), Komuna e Zveçanit me daten 16.09.2020 shpall:

**KONKURS PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE**

**Departamenti për Shëndetësi**

<b>1. Emri i vendit të punës:</b>	<b>Motër medicinale/tenik</b>
<b>Kushtet :</b>	<b>Shkolla e mesme e mjekësisë e përfunduar</b>
<b>Orët e punës:</b>	<b>40 orë në javë</b>
<b>Numri i ekzekutuesve:</b>	<b>2</b>

• Periudha e nënshkrimit të kontratës: Periudha provuese prej 6 (gjashtë) muajsh, me mundësi vazhdimi kontrate.

**INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURËN E KONKURENCËS**

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni (mirret në zyrën nr.33 në ndërtesën e Komunës së Zveçanit)
- Një kopje të diplomës (e vërtetuar nga noteri)
- Një kopje të certifikatës së ekzaminimit të jurisprudencës - nëse kërkohet (vërtetuar nga noteri).
- Certifikata e përvojës së punës.
- Dy rekomandime (nëse ka).
- Një kopje të dy raporteve të fundit të vlerësimit punës (nëse ka).
- Vertetim qe nuk është nën hetim dhe nuk është dënuar për një vepër penale.
- Kopja e letërnjoftimit.
- Çertifikata.

Informata të detajuara për të gjitha pozicionet me përshkrime të vendeve të punës, kualifikimet e kërkuara, përvojën e punës dhe aftësitë e tjera mund të merren në zyrën nr. 33 në ndërtesën e komunës së Zveçanit, si dhe në faqen e internetit të komunës [www.eopstinazvecan.com](http://www.eopstinazvecan.com).

**Konkursi mbetet i hapur për 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data 16.09.2020. deri më 30.09.2020.**

Kërkesat e dërguara pas mbylljes së konkursit nuk do të merren në konsideratë. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen, ata do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të konfirmimit nga email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumente origjinale të kualifikimit dhe trajnime.. Në rast të mosnjohjes së dokumentacionit origjinal, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/

"Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 te Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Aplikacionet mund të merren- shkarkohen dhe dorëzohen çdo ditë pune në Zyrën nr. 33 në ndërtesën e Komunës së Zveçanit - rruga Kralj Milutini p.n. prej ores 8:00 deri në orën 14:00.

Na osnovu Člana 8. Stav 1. Zakona o radu br. 03/L-212, člana 3. Stav 1. Administrativnog uputstva za regulisanje procedura radnog odnosa u javnom sektoru (Br.07/2017), Opština Zvečan, dana 16.09.2020. godine objavljuje:

**KONKURS ZA PRIJEM U RADNI ODNOS**

**Primarno zdravstvo**

<b>1. Naziv radnog mesta:</b>	<b>Medicinska sestra/tehničar</b>
<b>Uslovi:</b>	<b>Završena srednja medicinska škola</b>
<b>Radno vreme:</b>	<b>40 sati</b>
<b>Broj izvrsilaca:</b>	<b>2</b>

• Period zaključenja ugovora: Probni rad u trajanju od 6 (šest) meseci, uz mogućnost produženja ugovora

**OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE U VEZI SA PROCEDUROM KONKURISANJA**

**Tražena dokumentacija:**

- Aplikacija (preuzima se u kancelariji br.33 u zgradi opštine Zvečan)
- Kopija diplome (overena od strane notara)
- Kopija uverenja o položenom pravosudnom ispitu-ukoliko se traži (overeno od strane notara).
- Potvrda o radnom iskustvu.
- Dve preporuke (ako imate).
- Kopija dva poslednja izveštaja o vrednovanju rada (ako takve postoje).
- Potvrda da nije pod istragom i da nije osuđivan za krivično delo.
- Kopija lične karte.
- Sertifikati.

Detaljne informacije o svim pozicijama sa opisom posla, traženim kvalifikacijama, randim iskustvom i ostalim veštinama, možete dobiti u kancelariji br. 33 u zgradi opštine Zvečan kao i veb stranici opštine [www.eopstinazvecan.com](http://www.eopstinazvecan.com)

**Konkurs ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počev od 16.09.2020.god. do 30.09.2020.god.**


Zahtevi poslani nakon zatvaranja konkursa neće se uzeti u obzir. Nekompletirani zahtevi mogu biti odbijeni.

Zbog velikog broja dobijenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor, biće kontaktirani putem (e-maila) ili u nedostatku potvrđivanja email-om od strane kandidata, biće obavesteni putem telefona i dužni su da ponesu sa sobom originalna dokumenta o kvalifikacijama i izvršenim obukama. U slučaju nedostavljanja originalne dokumentacije, kandidati će biti isključeni iz regrutacione procedure.

Civilna služba Kosova pruža jednake uslove zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.

Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu predstavljeni proporcionalno na organima Javne službe na lokalnom i centralom nivou, kao što je naznačeno i Čl.11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.

Aplikacije se mogu preuzeti i podneti svakog radnog dana u Kancelariji broj 33 u zgradi opštine Zvečan – ulica Kralja Milutina b.b. u periodu od 8:00 do 14:00 časova



044 900 978 | 045 681 898



Sallon Depilimi Lume's Details



lumesdetails



Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:231/1  
Dt: 14.09.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### Ri SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikës me 16 orë mësimore;;  Një(1) mësimdhënës/e për Optikë me 10 orë mësimore:	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë  Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

#### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Shaqa Company" Sh.p.k Sojevë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit në Sojevë, Z.K. Tankosiq, komuna e Ferizajt.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.10.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Nesi" në Sojevë komuna e Ferizajt, do të organizohet debat publik nga kompania "Shaqa Company" Sh.p.k Sojevë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e betonit në Sojevë, Z.K. Tankosiq, komuna e Ferizajt.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhJS3IKdEVTV1F0NTFvZz09>

Meeting ID: 966 277 1284  
Passcode: 112233

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Sot më 15 shtator 2020 u mbushën një vit nga ndarja prej nesh e më të dashurit tonë



## **Prof. Dr. Ismet DËRMAKU**

Kujtimet për ty, urtësinë, mësimet dhe veprat tuaja do t'i ruajmë si të shenjta deri në përjetësi. Kontributi yt në fushën e arsimit dhe historisë ka vlerë të veçantë kombëtare dhe mbetet frymëzim edhe për gjeneratat e ardhshme.

Jemi krenar që të patëm e do të jeshë gjithnjë pjesë e pandashme e zemrave tona.

**E kujtojmë me dhimbje: djali Shani Dërmaçu me familje, nipat Ramadan Dërmaçu dhe Qamil Dërmaçu me familje.**